

Tregu unik evropian për shërbime financiare: vëzhgime nga Komiteti Evropian në Hije për Rregullime Financiare.♦

Harald A. Benink ab*, Reinhard H. Schmidt¹

Abstrakt

Megjithëse bota e bankingut dhe e financës po integrohet përditë e më tepër, në shumicën e pikëpamjeve, bota e rregullimit financiar vazhdon të përcaktohet nga kufijtë shtetërorë. Lojtarët kryesorë vazhdojnë të jenë qeveritë dhe agjencitë e tyre. Deri kohët e fundit, ato kanë tentuar të ndjekin një politikë të mbulimit të aktiviteteve të tyre nga anëtarë të komunitetit akademik sesa të mirëpresin një vlerësim kritik dhe shkëmbim të ideve.

Turbullimet në tregjet financiare ndërkombëtare në vitet '80 dhe ndikimi i tyre mbi bankat në SHBA, i dhanë shtytje nocionit që puna e akademikëve në fushën bankare dhe të rregullimit financiar, mund të jetë në një pozicion për të kontribuar në përmirësimin e rregullave në SHBA, duke rritur kështu stabilitetin e sektorit financiar. Kjo i dha shtytje krijimit të “Komitetit Amerikan në Hije për Rregullime Financiare”. Ndërkohë, komitete të tilla u themeluan në Evropë, në Japoni dhe në Amerikën Latine.

Problemet specifike të rregullimit financiar në Evropë, si dhe trajtat specifike që e veçojnë Komitetin Evropian në Hije për Rregullime Financiare nga institucionet homologe në SHBA dhe Japoni, janë rrjedhojë e faktit se Evropa, megjithëse ka bërë mjaft progres drejt integritimit politik dhe ekonomik, vazhdon të jetë një koleksion shtetesh me përbërje institucionale të ndryshme dhe tradita politike dhe ekonomike të ndryshme. Prandaj, në përpjekje për të punuar në drejtim të një trajtimi evropian në lidhje me rregullimet financiare, duhet përfshirë përpjekja për të promovuar zhvillimin e një kulture evropiane bashkëpunimi në këtë fushë, dhe kjo është çfarë Komiteti Evropian në Hije për Rregullime Financiare (KEHRRF) synon të bëjë. Në këtë studim, Harald Benink, kryetar i KEHRRF dhe Reinhard H. Schmidt, një nga dy anëtarët gjermanë, diskutojnë origjinën, objektivat dhe funksionimin e komitetit dhe fuqinë e rekomandimeve të tij.

© 2004 Elsevier B.V. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Fjalë kyçe: Komiteti Evropian në Hije për Rregullime Financiare; Shërbime financiare; Tregu unik

1. Hyrje

Komiteti Evropian në Hije për Rregullime Financiare i frymëzuar nga Komiteti Amerikan në Hije për Rregullime Financiare si dhe nga homologu japonez, u themeluan në vitin 1998. Komiteti Latinoamerikan në Hije për Rregullime Financiare u themelua në vitin 2000, kurse Komiteti Aziatik në Hije për Rregullime Financiare u themelua në vitin 2004. Të pesë komitetet përbëhen nga akademikë dhe ekspertë të tjerë të pavarur. Gjatë

takimeve të tyre të rregullta, ata nxjerrin rekomandime në lidhje me çështjet dhe trajtimet, si dhe me çështjet me interes aktual në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes bankare dhe tregjeve financiare. Nëpërmjet punës së tyre, komitetet mundohen të rrinë në “hije” (mbikëqyrës) të punës së autoriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare rregullative. Domethënë, ata vëzhgojnë, shqyrtojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike zhvillimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave të autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse.

Puna e Komitetit Evropian në Hije për Rregullime Financiare bazohet në supozimin që kontrolli dhe komentet kritikuese por konstruktive nga kërkues të pavarur, të cilët punojnë në të njëjtën fushë mund të japin një kontribut të rëndësishëm në cilësinë e diskutimit, në lidhje me rregullimin bankar dhe financiar në Evropë, në cilësinë e praktikave rregullatore dhe mbikëqyrëse dhe, së fundmi, në stabilitetin dhe eficiencën e sistemeve financiare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në këtë studim, i cili është një version i rishikuar dhe i përditësuar i Benink dhe Schmidt (2000), në fillim japim informacion mbi ambientin në lidhje me rrethanat, të cilat çuan në krijimin e Komitetit Evropian në Hije për Rregullime Financiare dhe diskutojmë objektivat e tij, përbërjen, strukturën dhe procedurat. Pastaj, ne japim një përshkrim të deklaratave që janë nxjerrë nga Komiteti Evropian në Hije për Rregullime Financiare. Gjatë prezantimit të strukturës dhe punës së komitetit, ne mundohemi të tregojmë praninë e një paraleli interesant ndërmjet Komitetit Evropian në Hije për Rregullime Financiare (KEHRRF) dhe fushës së tij vëzhguese: kompatibiliteti është, sipas nesh, aq i rëndësishëm për funksionimin e mirë të punës sa është edhe për efektivitetin e rregullimeve dhe mbikëqyrjeve financiare. Studimi përfundon me një vëzhgim të shkurtër mbi aktivitetet e ardhshme të KEHRRF dhe disa shënime mbi mënyrën se si ne e shikojmë potencialin dhe kufizimet e brendshme të kësaj përpjekjeje nga një grup i akademikësh dhe ekspertë të tjerë të pavarur nga vende të ndryshme, për të dhënë një ndihmesë kuptimplote në kulturën e përgjithshme të diskutimit të politikave ekonomike dhe në cilësinë e rregullimit financiar evropian.

2. Rregullimi financiar dhe bankar në Evropë

Sot, ka një konsensus të gjerë se është e nevojshme të rregullosh dhe të mbikëqyrësh institucionet financiare – sidomos bankat – dhe tregjet financiare. Në lidhje me objektivat e rregullimit dhe të mbikëqyrjes financiare, qëndrimi i përgjithshëm është se ato janë të nevojshme për të mbrojtur sistemin financiar nga rreziqet e përgjithshme, të cilat hasen në forma mjaft specifike dhe mundësisht mjaft të rrezikshme në sektorin financiar. Sa më shumë integrohet sistemi financiar evropian, aq më të rëndësishme bëhen aspektet e përgjithshme dhe më e rëndësishmja është që t'i shikojmë ato nga perspektiva rajonale dhe evropiane, dhe për të trajtuar problemin e rreziqeve në nivel rajonal. Bazuar në këtë, zhvillimi i një trajtimi evropian ndaj rregullimit dhe mbikëqyrjes bankare është plotësues ndaj detyrës tjetër të identifikimit dhe trajtimit të rreziqeve të ndryshme në nivel global. Një objektiv i dytë i rregullimit financiar ka të bëjë me mbrojtjen e konsumatorëve, të cilët nuk janë të informuar sa duhet për të mbrojtur veten e tyre dhe të cilët, do ta kishin tepër të vështirë dhe me kosto të lartë të merrnin informacion për të mbrojtur interesat e tyre¹. Gjithashtu, ka një konsensus në lidhje me nevojën e rregullimit të kësaj fushe.

¹ Pwr diskutime të bazws sw rregullores bankare, shih Bhattacharya et al. (1998), Burghof and Rudolph (1996), and Dewatripont and Tirole (1994), pwr diskutime të bazws sw rregullores sw kapitalit

Megjithatë, në këtë rast, do të kishte më pak nevojë për strategji dhe zgjidhje ndërkombëtare sesa në fushën e aktiviteteve rregullatore, të cilat kanë të bëjnë me rreziqe të përgjithshme. Tradicionalisht dhe sidomos në Evropë, bankat dhe tregjet financiare janë rregulluar për të promovuar objektiva të tjerë. Një nga qëllimet ka qenë për të siguruar përfitimin e fondeve të lira, fleksibël dhe të besueshme nga qeveria qendrore dhe ato lokale; një tjetër ka pasur të bëjë me promovimin e sektorit bankar dhe financiar vendas; gjithashtu, instrumentet rregullative janë përdorur për t'u dhënë formë zhvillimit të sektorëve jofinanciarë të ekonomisë, duke dhënë apo kufizuar kreditë sipas kritereve politike. Duke pasur parasysh natyrën e këtyre objektivave, është e qartë pse sektori financiar historikisht ka qenë dhe në disa raste vazhdon të jetë, sektori më i rregulluar i ekonomisë në shumicën e vendeve. Dhe, të paktën deri në njëfarë mase, dëshira për t'i çuar më tej këto qëllime, gjithashtu shpjegon pse, me gjithë futjen e monedhës unike, krijimit të një tregu unik dhe tendencës drejt integritimit evropian dhe globalizimit, rregullimi financiar vazhdon të shikohet si një ndërmarrje kombëtare në Evropë.

Interesat e brendshme të qeverive, të reflektuara në mbajtjen nën kontroll të sektorit financiar, shtojnë shqetësimin se në rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit financiar, dimensionet evropiane të sigurisë dhe shëndetit të sistemeve financiare mund të mos jenë duke marrë vëmendjen që u takon. Dikush mund ta kundërshtojë këtë vlerësim, duke treguar për koordinimin e vazhdueshëm dhe bashkëpunimin në nivel evropian, rezultatet e të cilëve reliktohen në direktivat evropiane; bashkëpunimi ndërmjet anëtarëve të Komitetit të Bazelit të rregullatorëve dhe mbikëqyrësve bankarë dhe përpjekjet nga grupi analog i rregullatorëve dhe mbikëqyrësve të tregut të kapitaleve (IOSCO). Por, ekzistenca e këtyre forumeve mbikombëtare nuk është e mjaftueshme për të hequr dyshimet, nëse një po kryhet një trajtim gjithëevropian ndaj rregullimit dhe mbikëqyrjes financiare. Tek e fundit, këto grupe përbëhen dhe në fakt mbizotërohen nga përfaqësues të qeverive të shteteve të ndryshme, mënyra e të menduarit e të cilëve mund të supozohet se pasqyron atë të interesave të qeverive që ata përfaqësojnë². Ka arsye të forta për të mos kërkuar krijimin e një agjencie të re mbikombëtare, e cila do të ishte përgjegjëse për rregullimin dhe mbikëqyrjen e industrisë financiare. Një arsye për të pasur rezerva ndaj përqendrimit të autoritetit në një agjenci të tillë është frika se mund të preket nga probleme tipike të burokracive të medha për shembull, se në shumë raste do të ishte shumë larg nga vendet në të cilat ndodh një problem specifik, për të qenë në gjendje të reagojë shpejt dhe në mënyrën e duhur, bazuar mbi informacion të besueshëm të dorës së parë. Një arsye tjetër është se përqendrimi i përgjegjësive brenda një agjencie rregullatore të centralizuar, mund të marrë përgjegjësi nga mbikëqyrësit kombëtarë, të cilët do të duhet të kenë rolin e tyre në një sistem të centralizuar dhe kështu, do të dëmtonte përkushtimin e tyre ndaj objektivave të sistemit dhe dëshirën e tyre për të zbatuar standardet. Për më tepër, centralizimi i autoritetit në një fushë, në të cilën interesat kombëtarë janë aq të fortë sa në sektorin bankar dhe financiar, do të çonte në komprimime të motivuara politikisht sipas proverbit “pjesëtuesi më i vogël i përbashkët” dhe gjithashtu, do të mbyste inovimin në

markets, see Pagano and Rœell (1992)

² Nw kwttw pikw, shih diskutimet e prezantuara nga Herring dhe Litan (1995) dhe nga Burghof dhe Rudolph (1996)

fushat e rregullimit dhe të mbikëqyrjes³. Së fundi, dhe ndoshta më me rëndësi, centralizimi nënkupton problemin e rëndësishëm të trajtimit dhe zbatimit të sistemeve të ndryshme ligjore kombëtare. Po ta marrim se ka argumente të forta në favor dhe kundër centralizimit të rregullimit financiar në nivel evropian, KEHRRF nuk ka marrë pozicion në favor të përqendrimit institucional ose të centralizimit. Dhe ndërkohë, KEHRRF kërkon të ofrojë një forum për diskutimin dhe vlerësimin kritik të politikave dhe praktikave rregullatore. Do të ishte e gabuar të supozonim se ata që e krijuan këtë iniciativë unike evropiane, ta shikonin rolin e saj si atë të një lobi për idenë e centralizimit institucional. Përkundrazi, KEHRRF e konsideron strukturën aktuale të decentralizuar si fakt dhe përpiqet të vlerësojë forma dhe mënyra të tjera për bashkëpunim dhe koordinim evropian dhe global dhe, aty ku është e mundshme dhe e nevojshme, për të promovuar adoptimin e tyre.

3. Origjina, përbërja, objektivat dhe procedurat e KEHRRF

3.1 Origjina dhe përbërja

Ideja për krijimin e KEHRRF u promovua fuqishëm nga George Kaufman, një nga iniciatorët dhe folësit më të mirënjohur të komitetit analog amerikan, model i cili gjithashtu, ishte marrë nga Komiteti në Hije për Tregun e Lirë. (4) Komiteti Amerikan në Hije për Rregullime Financiare (KAHRRF) përbëhet nga një numër akademikësh amerikanë, të cilët kanë dhënë kontribute të mëdha në literaturën mbi rregullimet financiare. KEHRRF ndjek mjaft ngushtë modelin e KAHRRF. Kjo ka treguar se sjell mjaft përparësi, për shkak se KEHRRF nuk ka pasur nevojë të shpenzojë kohë mbi diskutime në lidhje me objektivat dhe procedurat bazë.

KEHRRF u themelua në një takim në Bruksel në mars 1998. Anëtarët fillestarë u zgjodhën në bazë të një kriteri të përgjithshëm por aspak politik: u zgjodhën një numër vendesh evropiane dhe, në secilin vend, u kontaktuan një ose dy akademikë, të cilët mendoheshin të ishin ekspertë në fushën e rregullimit financiar dhe do të ishin të interesuar të merrnin pjesë në një bashkëpunim ndërkombëtar gjatë një periudhe të zgjatur kohe. Aktualisht, KEHRRF ka 13 anëtarë aktivë nga 12 vende. (5) Vendet e prezantuara nuk kufizohen vetëm me ato të BE, dhe sidomos nuk kufizohet vetëm në Zonën Euro. Një anëtare është nga Zvicra dhe një anëtar është amerikan, megjithëse ka studiuar në Angli dhe ka zhvilluar kërkime atje për shumë vite.

Një faktor tjetër në përzgjedhjen e anëtarëve, përveç sigurisë së përfaqësimit të shumë vendeve, ishte ideja se çdo anëtar duhet të ishte në një pozicion të tillë, që të kontribuonte me kompetencë në një fushë specifike si për shembull, ekonomi monetare, ekonomi financiare ose derivative përveç njohurisë së tij/saj mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen bankare. Një anëtar ishte në bordin e një banke të madhe ndërkombëtare, përpara se të bëhej profesor në universitet. Ndërkohë që shumica e anëtarëve janë ekonomistë, disa janë studiues të ligjit, të cilët janë specializuar në ligjin e tregjeve financiare dhe të

³ Lidhur me Komitetin e Bazelit Basel Committee, this negative aspect of international co-operation between regulatory and supervisory agencies is discussed in detail by Herring and Litan (1995, p. 132ff).

bankingut. Kështu, bazuar në kombësitë dhe fushat e specializimit profesional, anëtarët e KEHRRF janë një grup heterogjen. Ata mbajnë pozicione në universitete dhe institute kërkimore. Në qoftë se anëtarët do të punonin në sektorin financiar ose si anëtarë parlamenti, rregullatorë ose mbikëqyrës, kjo do të ishte parë si kompromentuese ndaj pavarësisë së KEHRRF, që është baza e besueshmërisë së tij.

Të paktën nga perspektiva evropiane, duket sikur KAHRRF mbron një pikëpamje mjaft specifike mbi çështjet rregullatore. Deklaratat e tij shpesh kanë një pozicion radikal liberal në sensin siç përdoret jashtë SHBA, e cila do të thotë një skepticizëm i thellë në lidhje me rregullimet e vendosura nga qeveria dhe, në të vërtetë, në ndërhyrjen qeveritare në ekonomi, në përgjithësi. Duke pasur parasysh mënyrën se si u themelua KEHRRF, mund të pyesim me vend, nëse ai ka të njëjtin orientim si homologu amerikan dhe në qoftë se jo, në qoftë se anëtarët e tij kanë ndonjë “filozofi rregulluese” të përbashkët. Përgjigja ndaj të dy pjesëve të kësaj pyetjeje është “jo”. Megjithëse disa anëtarë të KEHRRF kanë studiuar ose kanë qenë profesorë në një nga vendet Anglo-Saksone për një periudhë të gjatë kohe, dhe sigurisht janë influencuar mjaft nga kjo eksperiencë, KEHRRF nuk ka adoptuar pikëpamjen themelore të Komitetit Amerikan. Gjithashtu, nuk mund të thuhet, që në grup të mbrojnë një trajtim specifik ndaj çështjeve rregullatore. Duket sikur influenza e heterogjenitetit evropian është më e fortë se familiariteti i përbashkët i anëtarëve mbi diskutimet dhe pozicionet në SHBA mbi çështje rregullatore dhe mbikëqyrëse, dhe kjo i bën takimet e grupit mjaft interesante. Heterogjeniteti i grupit, i cili është rezultat i *background-it* kombëtar gjithashtu ka ndikuar mbi zgjedhjen e çështjeve për diskutim, mbi të cilat KEHRRF ka lëshuar deklarata dhe influenza e tij mund të duket në vetë deklaratat. Çështjet, mbi të cilat do të ishte e pamundur ose ndoshta mjaft e vështirë për të arritur konsensus, nuk përfshihen fare në axhendë. Siç do të shpjegohet më poshtë, ky trajtim i kujdesshëm ka luajtur një rol konstruktiv në punën e KEHRRF.

3.2 Objektivat

KEHRRF ka përkufizuar tre role për veten: të vëzhgojë dhe të komentojë në mënyrë kritike politikën dhe praktikën aktuale rregullatore; të shërbejë si urë ndërmjet akademisë dhe “botës reale”; dhe të përbëjë një Forum Evropian për diskutimin e çështjeve rregullatore dhe mbikëqyrëse. Funkcioni i parë është më i rëndësishmi. Ky “funksion në hije” nuk nënkupton një qëndrim kundërshtues, por e detyron KEHRRF të mbajë një lloj distance ndërmjet vetes dhe agjencive, aktivitetet e të cilave kërkon të vlerësojë. Sidoqoftë, ndërkohë që është e rëndësishme të mbajë distancë për shkak të objektivitetit, komiteti duhet që, në të njëjtën kohë, të bëjë përpjekje të mjaftueshme për të vlerësuar problemet, të cilat duhet të adresohen nga ata që bëjnë politikën rregullatore dhe mbikëqyrëse dhe për të vlerësuar kufizimet e rregullatorëve financiarë në nivelin e zbatimit të politikave. Në asnjë rast, komiteti nuk mund të bëjë kritikë “të butë” ndaj rregullatorëve apo të adoptojë një qëndrim “mbrojtës” ndaj tyre.

Të paktën në krahasim me situatën në SHBA, shkëmbimi i informacionit dhe i ideve në Evropë ndërmjet praktikuesve në fushën e rregullimit dhe të mbikëqyrjes, dhe i kërkuesve në fusha të përafërta ishte në qëllim mjaft i kufizuar, deri vonë. Në të njëjtën

kohë, sektori financiar dhe sfidat e praktikave rregullatore kanë ndryshuar shumë, siç kanë ndryshuar pozicionet e akademikëve mbi çështjet rregullatore dhe mbikëqyrëse. Turbullirat dhe krizat që ka kaluar sektori financiar në shumë vende që nga fillimi i viteve '80 (6) sugjerojnë që duhet ngritur një urë e fortë ndërmjet teorisë dhe praktikës. Duket sikur ka mjaft argumente se trajtimet konvencionale rregullatore nuk janë më të përshtatshme, për të përballur sfidat e tregjeve të sotme financiare. Rregullat e vjetra të mjaftueshmërisë së kapitalit të Komitetit të Bazelit dhe propozimi për ndryshimin e tyre, janë shembuj të mirë të këtij argumenti. (7) Një shkëmbim idesh ndërmjet akademikëve dhe praktikuesve, mund të ndihmojë në identifikimin e problemeve rregullatore, të cilat kërkojnë zgjidhje të reja dhe theksojnë mënyrat efektive për trajtimin e tyre. Çfarë nënkupton kjo për detyrat që KEHRRF i ka vënë vetes?

Sigurisht që ka shumë akademikë, të cilët parapëlqejnë të rrinë në “kalatë” e tyre sesa tua japin rezultatet e kërkimeve të tyre akademike (të cilat janë mjaft të sofistikuar) politikanëve dhe praktikuesve. Kjo normalisht përfshin “reklamimin” e rëndësisë dhe vlefshmërisë së këtyre rezultateve, dhe mundësinë që ato mund të kritikohen si të gabuara, të palidhura apo të pamundura për t’u zbatuar në praktikë. Sidoqoftë, KEHRRF beson se detyra e tij është të bëjë pikërisht këtë, domethënë të mundohet të nxjerrë strategji për veprim praktik nga teori akademike dhe në të njëjtën kohë, të testojë këto teori në lidhje me qenësinë dhe praktikitetin e tyre.

Nxjerrja e deklaratave ndaj politikanëve, politikëbërësve dhe praktikuesve, me pritshmërinë se ato do të merren seriozisht, është në fakt një mënyrë për të testuar teorinë, të cilat nënkuptojnë këto deklaratat. Megjithatë një deklaratë mund të jetë mjaft e bazuar nga pikëpamja akademike, autorët mund të jenë të detyruar të arrijnë në përfundimin se nuk ishte aq deklaratë e duhur, në qoftë se del se ata të cilëve u ishte drejtuar për shembull, një grup zbatuesish nuk e pranojnë deklaratën si të papërshtatshme ose si të pavlerë. Një reagim i vazhdueshëm negativ ndaj deklaratave të një komiteti në hije, jo vetëm që do të ulte besueshmërinë e këtij komiteti, por gjithashtu do të shkaktonte që politikëbërësit të ishin më pak të prirur për të pranuar këshilla nga komuniteti akademik. KEHRRF e ka të qartë se sa e rëndësishme është që të mënjanohet një gjë e tillë. Prandaj, mundohet që t’i marrë seriozisht problemet me të cilat përballen zbatuesit e deklaratave. Dhe në qoftë se zbatuesit e kanë të qartë se komiteti e kupton se sa e vështirë është të zgjidhen problemet në jetën e përditshme, atëherë kjo do të thotë që pjesa e parë e urës ndërmjet akademikëve dhe zbatuesve është ndërtuar. Rezultatet që dalin nga përparime në teori ekonomike si për shembull, fakti se garancitë e shprehura dhe të nënkuptuara për institucionet financiare rrisin rrezikun ose që “mendimi” se disa banka janë shumë të mëdha për të falimentuar, kanë pasoja negative (8) do të pranohen vetëm në qoftë se – dhe do të ndikojë në formulimin e politikave dhe praktikave rregullatore – kryhen përpjekjet e duhura për të treguar se këto rezultate mund të zbatohen në jetën e përditshme.

3.3 Procedurat

KEHRRF takohet gjatë dy fundjavave në vit (pa përfshirë takimin e përbashkët me komitetet e tjera simotra), dhe takimet e tij zhvillohen në qytete të ndryshme në Evropë.

Objektivi parësor është që të përgatisë një deklaratë mbi një çështje të zgjedhur në një takim të mëparshëm. Përpara se grupi të mbledhet, një ose dy anëtarë duhet të kenë përgatitur një deklaratë paraprake. Pas një diskutimi të shkurtër të përgjithshëm mbi subjektin e deklaratës së planifikuar, diskutohet deklarata paraprake – një mënyrë më e saktë të shprehuri do ishte “copa-copa” – për gati gjithë ditën, dhe pastaj zakonisht rishkruhet e tëra. Të hënën në mëngjes, drafti i ri i prezantohet grupit, diskutohet përsëri dhe përgatitet deklarata përfundimtare, e cila paskëtaj prezantohet në një konferencë për shtyp, që është njoftuar kohë më parë. (9)

Kjo procedurë është jozyrtare, por megjithatë mjaft strikte. Kjo përbën një sfidë të pazakontë për një grup profesorësh universiteti, për sa kohë që ata nuk janë mësuar me presione ndaj afateve strikte dhe megjithatë, prodhojnë diçka e cila është e mirë sa duhet për t'ia prezantuar një audience, e cila është gjithashtu mjaft e përgatitur mbi subjektin. Gjatë kësaj pune, merren parasysh opinionet e disa njerëzve me vullnet mjaft të fortë, të cilët vijnë nga përvoja të ndryshme. Duke pasur parasysh numrin e problemeve që mund të shkaktohen, kjo nuk është aspak një gjë e lehtë. Kështu, për ne ka sjellë mjaft kënaqësi fakti se deri tani ka qenë gjithmonë e mundur për të arritur në një pozicion që nuk është përpjestuesi më i vogël i mundshëm, megjithëse përfaqëson një kompromis të anëtarëve të grupit.

Hapi tjetër është shpërndarja e deklaratës. Objektivi përfundimtar është që të tërhiqet vëmendja e komunitetit rregullator evropian. Një kanal mjaft i rëndësishëm shpërndarjeje është shtypi financiar, i përfaqësuar nga gazetarë që punojnë për gazeta kryesore financiare. 10 Kështu, është e rëndësishme të sigurohemi që deklaratat nuk janë të mërzitshme, që ato nuk janë shumë diplomatike dhe të balancuara, që të thonë diçka që ia vlen të raportohet. Në anën tjetër, deklaratat duhet të jenë më tepër se një koleksion thëniesh provokative, sepse, ndërkohë që synimi fillestar është për të tërhequr gazetarët pranë konferencave të shtypit, synimi kryesor sigurisht që ka të bëjë me përçimin e mesazhit tek anëtarët e komunitetit rregullativ. Dhe kjo do të thotë që ata duhet ta marrin seriozisht atë mesazh, gjë e cila do të thotë se deklaratat duhet të jenë formuluar mirë dhe duhet të paraqesin një çështje të bazuar në argumente të forta. Sidoqoftë, në rast se deklaratat shkruajnë thjesht çfarë rregullatorët sidoqoftë e besojnë, ata me siguri do t'i shikonin ato si të bazuara dhe të arsyeshme, por nuk do t'i konsideronin si interesante.

Siç kemi vënë re, mënyra e shpërndarjes është pjesë e sistemit të motivimeve që është krijuar për komitetin, dhe qëllimi i këtij sistemi është të sigurojë që KEHRRF lëshon deklarata, të cilat jo vetëm paraqesin argumenta të fortë bazuar në informacion të saktë, por gjithashtu, janë interesante dhe kanë lidhje me punën në praktikë të rregullatorëve në vende të ndryshme evropiane. Si rezultat, KEHRRF duhet të kërkojë të arrijë një numër kriteresh kur formulon deklaratat e tij, të cilat përfshijnë arritjen e balancës ndërmjet objektivave të ndryshëm. Shkëmbimet e ndryshme të përfshira në këtë proces i bëjnë takimet e komitetit mjaft interesante, dhe kjo duket sikur siguron një motivim të fortë për pjesëmarrje të lartë të anëtarëve.

Kanali i dytë shpërndarës qëndron tek mesazhet e-mail nëpërmjet të cilëve, deklaratat u dërgohen direkt politikanëve, rregullatorëve dhe autoriteteve rregullatore e kolegëve akademikë. 11

Sigurisht, procedura e përdorur për prodhimin dhe shpërndarjen e deklaratave tona nuk mund të sigurojë që pozicionet që ne marrim, janë korrekte. Sidoqoftë, sistemi i motivimit dhe kontrollet sigurojnë që opinionet e paraqitura për konsideratën e grupit konsiderohen në mënyrë kritike, dhe kjo e ul shumë mundësinë që një pozicion i gabuar të adoptohet në një mënyrë jokritike dhe të shpërndahet “në emër të zgjuarsisë akademike”.

Deri më tani, janë zhvilluar katër takime të përbashkëta me nëngrupe anëtarësh të komiteteve simotra. Deklarata e takimit të parë të zhvilluar në Nju Jork, në qershor 1999, ishte një nga komentetet e para mbi kornizën e re mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, të cilën Komiteti i Bazelit e kishte shpërndarë vetëm para pak ditësh. 12

4. Deklaratat e KEHRRF

Që nga takimi themelues në Bruksel në mars 1998, KEHRRF ka nxjerrë dhe ka shpërndarë 15 deklarata. Të gjitha janë të ngjashme, përsa i përket gjatësisë dhe stilit. Ato nuk janë më shumë se 6 faqe dhe janë shkruar në një stil, i cili mënjanon zhargonin ekonomik dhe rregullator sa të jetë e mundur në mënyrë që të jenë të kuptueshme nga shumica e lexuesve të edukuar. Në vazhdim jepet një përmbledhje e shkurtër e të 15 deklaratave dhe identifikohen një numër çështjesh.

4.1 Trajtimi i problemeve të bankave në Evropë

Deklarata e parë synon të identifikojë mënyra nëpërmjet të cilave rregullimi dhe mbikëqyrja të ndërmarrin veprime parandaluese, në mënyrë që një bankë të mos e gjejë veten në një situatë në të cilën i gjithë kapitali i saj thithet nga humbjet dhe banka të bëhet insolvente. Në gjendjen aktuale, autoritetet përkatëse të vendit në të cilin gjendet një bankë me probleme zgjedhin një nga dy mënyrat e ndërhyrjes. Ose banka shpëtohet nëpërmjet shtimit të kapitalit, gjë që mund të bëhet nga Ministria e Financave ose nga banka të tjera, të cilat janë nën trysni të ndërmarrin veprime për ta shpëtuar, ose thjesht banka mbyllet nga agjencia mbikëqyrëse. Megjithëse në shumicën e rasteve, mbyllja e një banke nuk do të thotë që depozituesit e saj do t'i humbin paratë e tyre (një pjesë e madhe e depozitave tashmë janë të siguruara zyrtarisht ose jo në të gjithë vendet evropiane), dhe megjithëse falimentimi i një institucioni të vetëm nuk do të ndikojë mbi stabilitetin e të gjithë sistemit bankar, kjo do të çojë në humbje sociale për shembull, humbje të cilat ndikojnë jo vetëm pronarët e bankës që falimentoit. Ndërhyrjet zakonisht ndodhin mjaft vonë, dhe kur ato ndërmerren nuk janë të strukturuar mirë. Për më tepër, në qoftë se një bankë është në vështirësi serioze, të gjitha mundësitë e ndërhyrjes do të jenë të rënda për shkak të nevojës. Kjo është arsyeja kryesore pse ka kaq shumë përpjekje për të mënjeluar ndërhyrjet – ose për të vonuar marrjen e veprimeve të duhura. Mungesa e instrumenteve të diferencuara që mund të përdoren në mënyrë selektive – dhe në kohë për të mos lejuar që bankat të kenë probleme që në fillim – çon në tolerim dhe tërheqje.

Zgjidhja e rekomanduar nga KEHRRF është një trajtim, të cilin ai e quan “ndërhyrje e hershme e strukturuar dhe ristrukturim”. Kjo ka të bëjë me përkufizimin e një numri pikash alarmi për raportin e kapitalit – dhe disa tregues të tjerë operacionalë të një

problemi në lindje në një bankë të caktuar – dhe të përgjigjeve specifike në rast se arrihen këto pika alarmi. Në qoftë se raporti i kapitalit bie në një nivel të përkufizuar si pikë alarmi, autoriteti mbikëqyrës ka detyrim të fortë ligjor për të marrë masë, sipas listës së parashikuar të masave. Këto masa shërbejnë për të kthyer bankën në gjendje të shëndetshme. Në qoftë se gjendja e bankës vazhdon të përkeqësohet, megjithë ndërhyrjet e hershme, duhen marrë masa më të forta. Megjithatë, mund të arrihet në atë pikë, në të cilën mbikëqyrja duhet të ristrukturojë ose të mbyllë bankën.

Krijimi i një detyrimi strikt për të vepruar – qoftë ai i bazuar në ligj ose në ndonjë formë tjetër detyruese – e cila shkakton që mbikëqyrësit të ndërhyjnë në disa raste të përcaktuara mjaft qartë në mënyra të specifikuar por të diferencuara, do të kishte disa përparësi. Së pari, do të krijonte siguri për të gjithë në lidhje me kohën e ndërhyrjes për shembull, do të sigurohej një ndërhyrje e shpejtë nga mbikëqyrësit. Së dyti, do të ulte mundësitë dhe motivimin e pronarëve dhe të administruesve të bankave me probleme për të marrë pozicione të rrezikshme, në mënyrë që të “vinin bast për shpëtim” ose të spekulonin se bankat e tyre do ia arrinin ta kalonin periudhën e vështirë. Së treti, do të ulte motivimin që bankat të merrnin veprime të pakujdesshme që do t'i fusnin ato në probleme që në fillim.

Përparësia e katërt është se do të ndikonte shumë në luftën kundër praktikës së tolerancës rregullore dhe mbikëqyrëse, e cila është vëzhguar shpesh gjatë viteve të fundit, tolerancë, e cila shpesh i përkeqëson problemet. Detyrimi strikt i mbikëqyrësve për të vepruar, do të përmirësonte problemet e ndryshimeve në kohë, të cilat ndikojnë keq në praktikën mbikëqyrëse. Ky ndryshim në kohë apo inkonsistencë, nuk vjen si pasojë e tolerancës, e mungesës së ekspertizës ose për shkak të sjelljes së rrezikshme të mbikëqyrësve. Kjo vjen si pasojë “racionale” e faktit se, në një situatë krize, vendosja e sanksioneve që ata kanë thënë se do t'i zbatojnë në rast se ndodh një krizë, nuk është një parashikim i mirë për mbikëqyrësit. Së fundi, në qoftë se rregullatorët dhe mbikëqyrësit do të kishin një numër instrumentesh “të buta” përveç autoritetit për të mbyllur një bankë, do të rriste vullnetin e tyre për të marrë veprimin e duhur në një situatë të caktuar.

4.2 Bashkimi Monetar Evropian, Banka Qendrore Evropiane dhe mbikëqyrja financiare 14

Tema e deklaratës së dytë është struktura institucionale e mbikëqyrjes bankare në Evropë. Struktura aktuale është rezultat i Aktit Unik Evropian i vitit 1986 dhe Direktivës së Dytë mbi Kordinimin Bankar, e vitit 1989. Kjo direktivë kombinon një shkallë minimale të harmonizimit në fushën e rregullimit bankar me parimet e njohjes së përbashkët dhe kotrollit kombëtar. Ndërkohë, të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian e kanë zbatuar direktivën dhe rezultati ka qenë se rregullorja është pak a shumë e ngjashme në të gjithë vendet anëtare dhe mbikëqyrja bankare mund dhe duhet të kufizohet, në atë që kryhet nga autoritetet respektive në vendet anëtare.

KEHRRF i ka të qarta përparësitë e këtij trajtimi mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen bankare. Por, ndjen se trajtimi i decentralizuar duhet të mbështetet nga një shkallë kordinimi në nivel evropian, dhe se duhet të ketë një bazë institucionale për këtë kordinim. Prandaj, KEHRRF rekomandon krijimin e “Vëzhguesit Evropian ndaj

Rreziqeve të Përgjithshme”, i cili mundet ose jo të jetë pjesë e Bankës Qendrore Evropiane. Një funksion i rëndësishëm i këtij vëzhguesi do të ishte përmirësimi i rrjedhjes së informacionit, i cili mund të ketë shumë rëndësi në detyrën e vlerësimit të rrezikut të përgjithshëm brenda sistemit ndërvropian financiar dhe specifikiisht ndërmjet vendeve të ndryshme dhe autoriteteve të tyre rregullatore dhe mbikëqyrëse, dhe, në këtë mënyrë, për të ndihmuar rregullatorët dhe mbikëqyrësit kombëtarë për të bërë punën e tyre në mënyrë më eficiente.

Parimi i Bashkimit Evropian për kontrollin kombëtar bazohet në supozimin që rregullatorët dhe mbikëqyrësit e bankave kombëtare, kanë të njëjtin pozicion ligjor. Ky supozim i barazisë formale, sugjeron që autoritetet kombëtare janë gjithashtu, në terma të barabartë në ekspertizë profesionale dhe në mundësitë për të kryer funksionet e tyre, dhe sipas pavarësisë profesionale që gëzojnë. Në fakt, sidoqoftë agjencitë e ndryshme kombëtare mund të mos jenë kompetente në të njëjtin nivel ose njëlloj të pavarura. Faktet e nxjerra nga raste specifike në vende të ndryshme tregojnë që mbikëqyrësit e vendeve të BE, nuk janë të përgatitur njëlloj për të ndërmarrë veprime gjatë një krize bankare kombëtare, dhe se ata nuk janë njëlloj të pavarur nga lloji i presionit politik që mund të kufizojë qëllimin e këtij veprimi. KEHRRF beson se thjesht prania e një Vëzhguesi Evropian ndaj Rreziqeve të Përgjithshme, me të drejtën për të kërkuar informacion nga autoritetet mbikëqyrëse kombëtare, do të ndihmonte në krijimin e kushteve, nën të cilat ata do të mund të vepronin në mënyrë më uniforme, dhe kështu do të fuqizonin pavarësinë e këtyre agjencive dhe mundësitë e tyre për të kontribuar në harmonizimin e praktikës së mbikëqyrjes bankare në Evropë.

Në këtë kontekst, KEHRRF gjithashtu rekomandon që praktikat kombëtare në lidhje me veprimet e lëshimit të kredive si mundësi e fundit, duhen harmonizuar brenda Zonës Euro dhe se përgjegjësitë në këtë fushë duhen shpërndarë ndërmjet BQE dhe bankave kombëtare qendrore.

4.3 Drejt një tregjeve më të sigurta të derivativeve 15

Që nga fillimi i viteve '80, ka pasur një rritje spektakolare në tregtinë e derivativëve. Rritja ekstreme në tregjet për derivativë ka shtuar shqetësimet në lidhje me potencialin e tyre, për të ndikuar në stabilitetin e sistemeve financiare. Deklarata e tretë e KEHRRF trajton këtë çështje, dhe merret me rrezikun e tregjeve të parregulluar të derivativëve.

Këta derivativë nuk janë të standardizuar në lidhje me vëllimin, denominimin apo me termat e maturimit. Prandaj, ata nuk tregtohen në tregje shkëmbimi, që do të thotë që tregtia në këto lloj instrumentesh nuk është e rregulluar dhe e mbikëqyrur, dhe transaksionet në derivativë të parregulluar nuk janë të mbrojtura nga përfshirja e shtëpive të kleringut, të cilat do të eliminonin shumicën e transaksioneve dhe rrezikun e palëve të treta. Kjo është arsyeja përse kleringu dhe përfundimi i transaksioneve në këta derivativa shpesh çojnë në probleme. Për shembull, në qoftë se nuk përdoret një shtëpi kleringu, ekziston rreziku që një bankë të besojë se e ka mbrojtur një pozicion të rrezikshëm nëpërmjet një kontrate derivativësh me një bankë tjetër, dhe pastaj të zbulojë që për shkak të falimentimit të bankës së dytë, pozicioni nuk është i mbrojtur. Në qoftë se çështje të tilla përfshijnë sasi të mëdha parash, ato mund të çojnë në një krizë të përgjithshme.

KEHRRF ka nxjerrë një numër rekomandimesh, të cilat mund ta bëjnë tregun në këta lloj derivativash më të sigurtë. Një nga këto rekomandime ka të bëjë me kërkesat e kapitalit, të cilat bankat duhet të mbulojnë në lidhje me derivativat. KEHRRF beson se nevojat e kapitalit për pozicione në derivativa të parregulluar duhet të jenë më të larta se sa për derivativa që tregtohen në bursa. Kjo do të kishte dy përparësi. Një përparësi qëndron në faktin se kërkesa më të larta mbi mjaftueshmërinë e kapitalit do të pasqyronin faktin se rreziqet – sidomos, rreziqet e kleringut dhe të mbylljes së transaksioneve – janë më të larta. KEHRRF shikon një përparësi tjetër dhe ndoshta më të madhe në faktin që kërkesat më të larta për kapital për derivativët e parregulluar do të inkurajonin institucionet financiare që të përdorin derivativë të tregtueshëm (rregulluar) sa herë që është e mundur.

4.4 Përmirësimi i kuadrit të ri të Komitetit të Bazelit mbi mjaftueshmërinë e kapitalit

Deklarata e katërt e lëshuar nga KEHRRF u publikua si një deklaratë e përbashkët nga anëtarët e Komiteteve Hije të SHBA, Japonisë dhe Evropës. Kjo deklaratë ishte përgjigja e parë zyrtare ndaj versionit draft të një “kuadri të ri mbi mjaftueshmërinë e kapitalit”, të cilin Komiteti i Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare (Komiteti i Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare, 2001) e kishte nxjerrë vetëm pak ditë më parë, për të filluar një diskutim mbi pozicionin e tij dhe për të përfutur komente nga anëtarë të komunitetit rregullator, akademikët dhe vëzhgues të tjerë me njohuri në skenën bankare 17. Deklarata e katërt ka të bëjë me pyetjen në vazhdim: Cili është trajtimi më i mirë thelbësor ndaj problemit të përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe përcaktimi i mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat? Fakti është që meqënëse kjo çështje u trajtua vetëm pak ditë pas publikimit të Komitetit të Bazelit, KEHRRF përmbushi një nga detyrat, të cilat i ka vënë vetes – atë të mbikëqyrjes dhe të komentimit kritik mbi punën e autoriteteve rregullatore ndërkombëtare.

Në zemër të propozimit të ri të Komitetit të Bazelit është një rishikim i peshave të rrezikut për klasa individuale asetesh, të cilat përdoren në përcaktimin e kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit bazuar në rrezikun e kreditit për një bankë aktive në tregjet ndërkombëtare. 18 Ana tjetër e “ekuacionit”, për shembull, përkufizimi i asaj se çfarë përbën kapitalin e një banke dhe përqindjen e asetëve të mbrojtura nga rreziqet, e cila duhet të jetë gjendje në formë kapitali, nuk është specifikuar nga propozimi i ri i Bazelit, kështu që nuk diskutohet gjatë në deklaratën e Komiteteve në Hije.

Siç dihet mjaft mirë tashmë, versioni i parë i kuadrit të Komitetit të Bazelit mbi mjaftueshmërinë e kapitalit kaloi nëpër një trajtim të ri, i cili do t`u lejonte kredimarrësve rënditje të jashtme të rrezikut, siç jepet nga agjencitë e listimit të rrezikut të kreditit dhe nga renditjet e brendshme të “bankave të sofistikuar” – term i përdorur ky në propozimin e Bazelit – për t`u përdorur në përcaktimin e peshës së rrezikut për kreditë.

Komitetet në Hije janë të mendimit se, krahasuar me sistemin aktual, i cili bazohet në klasa arbitrare rreziku, (19) trajtimi i përcaktuar në propozimin e ri përbën një hap në drejtimin e duhur. Sidoqoftë, ai nuk eliminon problemin kryesor të metodës aktuale të përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit të një banke, përderisa propozimi i ri ruan “trajtimin e parafinuar për matjen e rrezikut të një portofoli”, siç cilësohet nga vetë Komiteti i Bazelit. Ky trajtim është i parafinuar jo vetëm për shkak të konceptit të rrezikut të portofolit mbi të cilin bazohet, por edhe sepse është një mënyrë e papërshtatshme për të arritur atë që synon rregullimi i kapitalit. Rreziku në një portofol të

çfarëdo lloji – duke përfshirë një portofol të përbërë nga kredi – nuk është thjesht i barabartë me shumën e rreziqeve të veçanta në portofol. Dhe ndërsa një trajtim më i sofistikuar dhe i diferencuar është i nevojshëm, do të ishte mjaft problematike të lejonim banka të veçanta të vlerësojnë vetë nivelin e rrezikut në portofolet e tyre. Kjo mund të sjellë motivime të forta për bankat, për të mos dhënë informacion të saktë mbi nivelin e rrezikut dhe gjithashtu, do të krijonte punë të madhe për mbikëqyrësit bankare, të cilët do të monitoronin cilësinë sistemeve të brendshme të kontrollit të rrezikut.

Duke pasur parasysh këto probleme, deklarata e lëshuar nga tre Komitetet në Hije përmban një propozim inovativ, dhe sipas nesh mjaft të vlefshëm, i cili bazohet mjaft në kontribute të mëparshme të Charles Calomiris, anëtar i Komitetit Amerikan në Hije. Ky propozim përshkruan një trajtim, i cili lejon që informacioni dhe interesat që kanë pjesëmarrësit e tregut të përdoren për qëllimin e rregullimit bankar.

Ndër agjentët e ndryshëm ekonomikë që operojnë në tregjet financiare, investitorët profesionalë prezupozohet se kanë informacionin më të mirë. Në qoftë se këta pjesëmarrës të tregut i japin kredi një banke, në formën e një borxhi të varur, i cili nuk mund të tërhiqet kur kredidhënësi kërkon t'i kthehen paratë dhe duhet të zëvendësohet me kredi të reja në intervale të shkurta, atëherë interesi shtesë (spread) mbi këto kredi mund të interpretohet si tregues i aftësisë së bankës për të kryer pagesa, siç vlerësohet nga tregu. Ky është një interes shtesë dhe tregues i rrezikut.

Implikimet e këtij perceptimi në lidhje me rregullimin e aftësisë për të kryer pagesat janë të drejtpërdrejta. Në vend të përcaktimit të një kufiri të sipërm për borxhet e subordinuara si përbërës i të ashtuquajturit kapital me dy nivele, që në fakt është ajo çfarë bën Akordi i tanishëm i Bazelit, kuadri mbi mjaftueshmërinë e kapitalit duhet t'u kërkojë bankave ndërkombëtare dhe bankave në vende, të cilat kanë një treg aktiv ndërbankar, të kenë një minimum borxhi të varur gjatë gjithë kohës. Vendosja e një kërkesë të tillë duhet të krijojë një mekanizëm efektiv motivimi. Emetuesit e borxheve të subordinuar do të kishin motivim të lëshonin informacion për bankat që e blejnë këtë borxh, duke kërkuar një normë interesi, e cila e reflekton si duhet rrezikun e aseteve; dhe do të ishin të motivuar të monitoronin aftësinë e kredimarrësit për të paguar, në mënyrë që të mbrojnë fondet e tyre dhe të sigurohen që do të jenë të informuar mirë kur të vijë koha për rinovuar kredinë. Kredimarrësit duhet të kenë të njëjtin motivim për të ulur rrezikun shtesë mbi një borxh të subordinuar, të cilin ata do të duhet ta marrin përsipër. Ata mund ta arrijnë këtë duke u siguruar që kanë një sasi të mjaftueshme kapitali, çfarë është ajo që rregullatorët dhe mbikëqyrësit kërkojnë prej tyre. Por, kjo nuk është e vetmja përparësi e propozimit. Mbikëqyrësit bankarë mund ta vëzhgojnë mjaft lehtë rrezikun shtesë nga një borxh i subordinuar i një banke të caktuar, gjë që do të kërkohej nga kredidhënësit. Dhe ata do të kërkonin të interpretonin një rritje në rrezik – ose në raste ekstreme, pamundësinë e vëzhguar të bankës për të marrë kredi të subordinuara me çfarëdo çmimi – si sinjal që diçka ka ndodhur që ka nevojë për vëmendjen e tyre. Në mënyrë alternative, mbikëqyrësit e bankës mund t'i përkufizonin ngjarjet e këtij lloji, si sinjalizuese për inspektime në vend ose masa të tjera nga arsenalin e ndërhyrjeve të strukturuar, të diskutuara më lart. Në qoftë se mbikëqyrësit do ta përdorin këtë mundësi, ndërhyrjet e tyre mund të ishin të kufizuara me qëllim, sepse ato do të ndërmerreshin me shpejtësi dhe si duhet.

4.5 Një rol i ri për sigurimin e depozitave në Evropë 20

Deklarata e pestë trajton çështjen, nëse sistemet e sigurimit të depozitave në Evropë kanë nevojë të modifikohen, për të marrë parasysh faktin që sistemi aktual financiar evropian po kalon një proces të shpejtë integrimi. Ndryshimet në sistemin financiar, që e kanë fokusuar vëmendjen në këtë çështje, rrjedhin nga rritja e konkurrencës dhe një valë ristrukturimi e sektorëve financiarë kombëtarë dhe ato duhet të çojnë në rritjen e mundësisë së mosaftësisë së kryerjes së pagesave nga bankat, në vitet në vazhdim. Si rezultat, KEHRRF arrin në përfundimin se ndryshimet në sistemet e sigurimit të depozitave janë të nevojshme dhe specifikon llojet e veprimeve që duhen ndërmarrë. KEHRRF rekomandon që Direktiva Evropiane e vitit 1994 për Sigurimin e Depozitave të qartësohet dhe të modifikohet si vijon:

- 1) Institucionet financiare duhet të lejohen të reklamojnë që fondet e depozitorëve janë të siguruara në disa raste të caktuara dhe deri në një nivel të përcaktuar saktë. Përderisa mbulimi i sigurimit ndryshon në vende të ndryshme, rritja e transparencës e krijuar nga ky ndryshim në direktivë do të ishte e mirëpritur.
- 2) Në rastin e falimentimit të një banke, institucionet e garantimit duhet të rimbursojnë menjëherë depozitorët, të cilëve u takon ky rimbursim dhe të mos presin tre muaj për të bërë një gjë të tillë. Ky ndryshim do të ulte mundësinë e tërheqjeve të njëkohshme në banka.
- 3) Duhet të jetë mjaft e qartë për depozitorët se nuk ka ndryshim ndërmjet qëllimit të deklaruar të garancive të depozitave dhe shtrirjes efektive të këtyre garancive; me fjalë të tjera, duhen ndërmarrë hapa për të siguruar që autoritetet përkatëse nuk i kalojnë kufijtë zyrtarë të garancive. Në qoftë se kjo gjë nuk është e detyruar, do të jetë e pamundur që të krijohet trysnia e duhur në treg, e cila është e nevojshme për të disiplinuar bankat dhe për t'u dhënë atyre motivimin për të kufizuar sasinë e rrezikut që marrin përsipër.
- 4) Duhet përdorur prime sigurimi të bazuara në rrezik. Këto premiumë duhet përcaktuar në bazë të treguesve të tregut mbi rrezikun e pamundësisë për të paguar si propozohet në deklaratën e katërt dhe pagesat në fondet e sigurimeve duhet të bëhen përpara dhe jo pasi të ndodhë një rast i pamundësisë për të paguar.

Të gjitha këto propozime motivohen nga shqetësimi se sisteme të sigurimit të depozitave, të cilat KEHRRF i shikon si politikisht dhe ekonomikisht të paevitueshme, mund të kenë efekte negative motivuese, dhe duke pasur bindjen që sisteme të tilla nuk duhet të kenë këto lloj efektesh, në qoftë se janë të hartuara si duhet. Rekomandimet e mësipërme bazohen akoma më tepër në atë se në botën reale, alternativa ndaj pasjes së një sistemi zyrtar të garantimit të depozitave nuk ka të bëjë me mospasjen e tyre, por me përdorimin e garancive jozyrtare ose të nënkuptuara. Duke pasur parasysh këtë situatë, propozimet e KEHRRF do t'i shërbejnë dy qëllimeve. Së pari, ato do ta bëjnë të mundur dhe të dëshirueshme për autoritetet kombëtare që të likuidojnë bankat që nuk mbulojnë pagesat se sa ti shpëtojnë ato, gjë që është bërë shpesh nga mbikëqyrësit në të shkuarën; së dyti, ato do të bëjnë të papëlqyeshme për bankat që të marrin një sasi të tepërt rreziku.

4.6 Bashkimet midis bankave dhe blerjet e tyre në Evropë 21

Deklarata e gjashtë e KEHRRF ka të bëjë me bashkimet dhe blerjet e institucioneve financiare në vende të ndryshme evropiane. Deklarata pastaj vazhdon me supozimin se në të ardhmen do të ketë më shumë transaksione të tilla ndërmjet bankave evropiane dhe e njeh faktin që rregullat dhe politikat aktuale kombëtare përbëjnë pengesa specifike mbi bashkimet dhe blerjet në industrinë bankare. Për më tepër, politikat në këtë fushë ndryshojnë ndërmjet vendeve të ndryshme dhe ato nuk janë transparente sa duhet. Kështu që, bashkimet dhe blerjet përtej kufirit në sektorin bankar i nënshtrohen një rreziku specifik politik, për shembull, rreziku që politikat dhe qëndrimet kombëtare do t'i pengojnë këto transaksione të kapitalit ndërmjet vendeve, duke e bërë kështu të pamundur përfitimin nga efienca, të cilat mund të rezultojnë nga transaksione të këtij lloji.

KEHRRF mendon se autoritetet kombëtare duhet të vazhdojnë të kenë dhe të përdorin të drejtën e tyre për të dhënë opinion mbi aspektet e bashkimeve apo të blerjeve ndërkufitare, të cilat kanë të bëjnë me aftësinë për të kryer pagesat dhe qeverisjen. Sidoqoftë, çdo opsion i cili mund të pengojë një transaksion të këtij lloji, duhet të kufizohet në raste në të cilat ka shqetësime në lidhje me çështje të konkurrencës apo në lidhje me sigurinë dhe shëndetin e sistemeve respektive financiare. Ky kufizim i qëllimit për veprim nga ana e autoriteteve kombëtare, do të rriste transparencën dhe do ta bënte më të thjeshtë për institucionet financiare evropiane të bëjnë planifikime afatgjata dhe të përfundojnë marrëveshje të nevojshme, për të arritur synime strategjike në tregun evropian. Në të njëjtën kohë, KEHRRF rekomandon se Komisioni Evropian duhet të ndërmarrë hapa për të harmonizuar dhe liberalizuar politikat dhe rregullat e ndryshme kombëtare në lidhje me blerjet dhe bashkimet ndërmjet shteteve.

4.7 Renditjet e brendshme, standardet e kapitalit dhe borxhi i subordinuar (22)

Në deklaratën e tij të shtatë, KEHRRF i kthehet kuadrit të ri mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, të propozuar nga Komiteti i Bazelit në vitin 1999 dhe deklaratës së përbashkët të tre Komiteteve në Hije të diskutuar më lart, e cila shpjegon se si përfshirja e kërkesave në lidhje me borxhin e subordinuar mund të lehtësojë rregullimin e kapitalit.

Një trajtë e rëndësishme e propozimit origjinal është se i jep një rëndësi të veçantë renditjeve të jashtme në përcaktimin e peshës së rrezikut. Nga perspektiva evropiane, ky propozim duhet të shikohet si problematik. Renditjet e jashtme nuk përdoren gjerësisht në Evropë dhe si rezultat një trajtim i tillë do të krijonte një disavantazh të papërshtatshëm konkurrence për bankat evropiane. Kjo kritikë është shprehur mjaft qartë nga shumë pjesëmarrës në diskutimin në vazhdimësi për opsione në lidhje me reformën e kuadrit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Komiteti i Bazelit u është përgjigjur këtyre shqetësimeve duke caktuar një rol më të rëndësishëm për renditjet e brendshme. Në deklaratën e tij, KEHRRF mirëpret këtë zhvendosje të rëndësisë sepse renditjet e brendshme mund të paktën të ofrojnë disa hapësira për të përfshirë aspektet e portofolit në matjen e ekspozimit të një banke ndaj rrezikut, dhe për shkak se përdorimi i tyre është më i përshtatshëm me logjikën ekonomike të bankngut sesa nga përdorimi i renditjeve të jashtme. Por KEHRRF gjithashtu, shpreh shqetësimin se përdorimi i renditjeve të brendshme si bazë për përcaktimin se sa kapital duhet të ketë një bankë, mund t'i inkurajojë ato që të manipulojnë dhe të keqpërfaqësojnë informacionin, dhe se mbikëqyrësit bankarë, mjaft rrallë mund të jenë në një pozicion për t'i parandaluar ata që

ta bëjnë këtë. (23) Këto probleme nuk mund të eliminohen duke u kërkuar bankave që të lejojnë mbikëqyrësit bankarë të kontrollojnë sistemet e tyre të brendshme të renditjes. Ajo çfarë duhet është një mekanizëm motivimesh, i cili do t'i bënte bankat që të japin informacion të saktë për mbikëqyrësit.

Një mekanizëm i tillë mund të jetë kërkesa që bankat të kenë një pjesë minimale “detyrimesh të besueshme të pasiguruara”, për shembull, borxh i subordinuar, i cili rekomandohet në deklaratën numër katër dhe i diskutuar më lart. Përdorimi i renditjeve të brendshme në lidhje me një kërkesë, e cila mandaton një nivel të caktuar të borxhit të subordinuar është një opsion mjaft tërheqës, dhe rekomandohet fuqishëm nga KEHRRF. Megjithë faktin se një skemë e detyruar mbi borxhin e subordinuar do të rriste disa probleme në rastin e bankave të vogla, një skemë e tillë është një pjesë e qenësishme e çdo standardi mbi kapitalin, i bazuar në renditjet e brendshme. Me të vërtetë është një element i nevojshëm për një standard të këtij lloji, pasi pa patur një skemë të tillë, një standard i bazuar në renditjen e brendshme me siguri nuk do të funksiononte, dhe pa një standard të brendshëm mbi renditjen, kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit nuk do t'i shërbenin qëllimit të tyre, që ka të bëjë me përmirësimin e sigurisë dhe të shëndetit të sistemit bankar.

4.8 Drejt një tregu unik evropian për tregtinë e letrave me vlerë²⁴

Gjatë dekadës së fundit, zhvillimi i tregjeve evropiane për letrat me vlerë ka qenë një sukses i madh. Meqënëse kjo ka pasur lidhje direkte me konkurrencën ndërmjet vendeve, bursat evropiane kanë kryer reforma të mëdha në sistemet e tregtimit dhe të qeverisjes së brendshme, të cilat kanë përmirësuar mjaft efektivitetin e tyre dhe kanë ulur kostot e tregtimit për investitorët. Megjithatë, bursat tani po përballen me presione të fuqishme nga kompanitë kryesore të tregtisë ndërkombëtare, për të ulur edhe më tej kostot duke konsoliduar veprimet në akoma më pak platforma. Kjo ka shkaktuar një valë dramatike propozimesh për bashkime dhe aleanca, të cilat paralajmërojnë një ristrukturim thelbësor të terrenit konkurrues në veprimet tregtare dhe rishpërndarjen e autoritetit të rregullimit tregtar nëpër komisionet kombëtare të letrave me vlerë në vendet e BE.

Komisioni Evropian aktualisht po ndërmerr një rishikim të Direktivës mbi Shërbimet Investitore (DSHI) të vitit 1993, si pjesë e “planit të veprimit për shërbimet financiare”, me qëllim që të propozojë reforma të gjera. Në deklaratën e tij më të fundit, KEHRRF i kërkon Komisionit Evropian të trajtojë një dobësi kryesore në DSHI – konceptin e ashtuquajtur “tregje të rregulluara” – i cili aktualisht mund të përdoret nga autoritetet kombëtare si armë mbrojtëse.

Neni 15.4 i DSHI parashikon “pashaportë unike” për sistemet tregtare të BE, duke lejuar që një sistem i autorizuar nga një autoritet kompetent në një juridiksion kombëtar, të ofrojë shërbime për të gjithë të tjerët. Kjo pasaportë unike është manifestim i konceptit të “njohjes reciproke” dhe “kontrollit vendor”, i cili përdoret në një numër direktivash të programit për tregun unik, për të lehtësuar integrimin e tregjeve pa qenë nevoja për harmonizim paraprak të ligjeve dhe rregulloreve në vendet e BE. Kontrolli kombëtar jep një stimul shtesë për integrimin e tregut, duke mos lejuar tendenca të natyrshme mbrojtëse të autoriteteve të një vendi, që mund të provojë të pengojë veprimet e konkurruesve të huaj kur ata çenojnë kompanitë vendase.

Pasaporta unike e DSHI-së, sidoqoftë, zbatohet vetëm për të ashtuquajturit “tregje të rregulluara”. Përkufizimi i tregjeve të tilla ishte burim debatesh brenda Këshillit të Ministrave të BE gjatë negociatave të DSHI-së, të cilat filluan në vitin 1988. Në qoftë se një bursë apo një sistem tregtimi nuk ishte një ligjërish një “treg i rregulluar”, atëherë ky treg ishte i detyruar të kërkonte autorizim për të vepruar në çdo juridiksion kombëtar në të cilin do të donte të ofronte shërbime, edhe në qoftë se këto shërbime do të ofroheshin nëpërmjet lidhjeve të izoluara elektronike. Proteksionizmi lokal ishte pra një kërcënim për çdo operator të sistemeve të tregtimit, i cili nuk mund të plotësonte kriteret e “tregut të rregulluar”.

DSHI-ja bashkon pa qenë nevoja, rregulloret për dhënien e informacionit nga korporatat me atë të sistemeve të tregtimit. Listimi i letrave me vlerë në përputhje me standardet bazë, konsiderohet një shenjë dalluese e një “tregu të rregulluar” dhe marrja e një pasaporte unike varet prej saj. SEAQ International duke mos i listuar aksionet kontinentale të cilat tregtonte në fundin e viteve '80 dhe fillimin e viteve '90, një kërkesë zyrtare për t'i listuar përbënte një kërcënim për veprimet ndërkombëtare të saj. Një ndarje veri-jug u shfaq në Këshillin e Ministrave gjatë negociatave për DSHI, në lidhje me kërkesën për listim gjë e cila çoi në një kompromis mbi një tekst mjaft të paqartë. Neni 1.13 specifikon se një “treg i rregulluar” duhet të kënaqë kërkesat e Direktivës mbi Mënyrat e Listimit (79/279/EEC) “aty ku [Direktiva] është e aplikueshme”. Mosidentifikimi i organit që përcakton se kush e përcakton se ku direktiva është e aplikueshme, krijon hapësirë për proteksionizëm nga autoritetet kombëtare në favor të operatorëve kombëtarë të këmbimit.

KEHRRF do të donte të shikonte lindjen e një tregu konkurrues për shërbimet e listimit në Evropë, ku jo-bursat do të konkurronin drejtpërdrejt me bursat, për vendosjen e standardeve të duhura në lidhje me moshën dhe madhësinë e kompanive, të cilat dëshirojnë të listohen. Forcat e tregut vetëm mund të përmirësohen duke lejuar specializimin ndërmjet shërbimeve të listimit dhe të tregtimit (ndarja e listimit dhe e tregtimit). Në mënyrë që të lëvizet në këtë drejtim, DSHI-ja duhet rishikuar në mënyrë të tillë që të jetë e qartë se (a) ndërkohë që “tregjet e rregulluara” mund të jenë të detyruara nga disa vende të operojnë vetëm në aksione të listuara, funksioni i listimit të mund të kryhet nga çdo bursë ose organizëm tjetër (si për shembull, një firmë auditimi, agjenci renditjeje ose institucion qeveritar) i autorizuar për ta ofruar shërbimin e listimit në çdo treg kombëtar të vendeve të BE; dhe (b) autoritetet kombëtare janë të autorizuar për të vendosur nëse Direktiva mbi Mënyrat e Listimit është e aplikueshme. Kjo do të siguronte se një operatori në bursë të përcaktuar si “treg i rregulluar” në një juridiksion nuk i mohohen të drejtat e pasaportës unike në një juridiksion tjetër, mbi bazën se ky operator në vetvete nuk i “liston” letrat me vlerë të cilat ai tregton.

Një dobësi tjetër e mundshme e DSHI-së ka të bëjë me konceptin e ashtuquajtur “tregje të reja”. Neni 15.5 thotë se neni 15 “nuk ka efekt mbi të drejtën e vendeve anëtare për të autorizuar ose jo krijimin e tregjeve të reja në territoret e tyre”. Kjo klauzolë është e panevojshme, në qoftë se qëllimi i saj i vërtetë ka të bëjë me forcimin e të drejtës së vendeve për të caktuar “tregje të rregulluara”. Por, qëllimi në fakt ka të bëjë me sigurimin

e një klauzole shpëtimi për vendet anëtare ndaj klauzolës së pasaportës unike për sisteme të kontrollueshme tregtimi. Duke e deklaruar një sistem tregtimi të huaj si “treg të ri”, një vend anëtar mund t’i mohojë atij të drejtat e pasaportës unike. Në mënyrë që të pengohet një veprim i tillë, KEHRRF rekomandon heqjen e nenit 15.5.

4.9 Reforma e rregullimit bankar dhe aplikimi i saj në Japoni 25

Në kundërshtim me deklaratat e qeverisë, sektori financiar japonez mbetet i brishtë. Një vazhdim i politikave aktuale do të rrisë kostot ndaj taksapaguesve japonezë. Tregu i aksioneve reflekton mjaft qartë skepticizmin e thellë mbi shëndetin e këtij sektori. Bankat kanë pak kapital. Primet aktuale të sigurimit të depozitave janë të pamjaftueshme. Marzhet e kredive janë shumë të vogla për të mbuluar rrezikun e kreditit. Qeveria i shton këto probleme duke i nënshtuar bankat ndaj konkurrencës së subvencionuar nga institucionet shtetërore, për shembull, sistemi postar i kursimit dhe Korporata Japoneze e Financimit të Strehimit, ndërkohë u bën presion atyre për të rritur kreditë ndaj SME-ve, me norma interesi poshtë atyre të tregut.

Kapitali i raportuar i sistemit bankar japonez është 35 trilion jen, i cili mbivlerësohet me 8.2 trilion jen taksash të shtyra dhe përfshin 7.5 trilion jen kapital qeveritar, të cilin bankat kanë premtuar ta kthejnë. Kjo bazë kapitali është mjaft e vogël në krahasim me kreditë problematike të parazervuara të cilat arrijnë në rreth 52 trilion jen. Gjithashtu, duam të theksojmë se bankat ndërkohë kanë humbur 66 trilion jen (13 për qind e PBB) që nga viti 1992.

Ndarja e aksioneve ndërmjet institucioneve financiare dhe ndërmjet sektorëve financiarë dhe atyre jofinanciarë, shton rrezikun ndaj stabilitetit. Aksionet e korporatave në zotërim të bankave, tashmë janë gati sa dyfishi i kapitalit privat. Për më tepër, bankat dhe kompanitë e sigurimit të jetës kanë shkëmbyer shuma të mëdha borxhi të subordinuar, duke fryrë kapitalin e tyre rregullator ndërkohë që ekspozojnë njëra-tjetrën ndaj dobësive respektive.

KEHRRF beson se sistemi financiar japonez ka nevojë për iniciativat e specifikuar më poshtë.

4.9.1 Zgjidhja e problemit të dobësisë së institucioneve financiare

Së pari dhe më me rëndësi, zgjidhja e problemit të institucioneve financiare që nuk arrijnë të kryejnë pagesat është parakusht për një sistem financiar të shëndetshëm. Për të identifikuar institucionet që nuk arrijnë të kryejnë pagesat kërkohet një eliminim më agresiv nga llogaritë, i kredive të këqija. Zgjidhja e çështjes së Bankës për Kredi Afatgjatë të Japonisë dhe Bankës së Kredive Nipon, krijon shqetësime pasi nuk është kryer procesi i duhur përpara shitjes së tyre tek investitorët privatë. Prandaj, një garanci qeveritare për portofolin e kredive duhet të ofrohej nga Korporata e Sigurimit të Depozitave (KSD). Në të ardhmen, garancia qeveritare duhet të zëvendësohet nga një rregullim eksplicit për ndarjen e humbjeve ndërmjet KSD-së dhe blerësve.

4.9.2 Standardet për kapitalin dhe veprimet e menjëhershme korrigjuese

Zbatimi strikt i veprimeve korigjuese ndaj bankave dhe kompanive të sigurimit të jetës është i nevojshëm. Bankat që mund të kryejnë pagesat por që nuk kanë kapital të mjaftueshëm duhet të detyrohen të shtojnë kapitalin nga tregu privat. Falimentimi i vazhdueshëm i kompanive të sigurimit të jetës, që kishin marzhe relativisht të larta të kryerjes së pagesave, tregon se është i nevojshëm një forcim i marzheve të kryerjes së pagesave.

Në mënyrë që sistemi financiar japonez të shëndoshet, është e rëndësishme që të hiqet kapitali i dubluar ndërmjet institucioneve financiare. Bankat nuk duhen lejuar që të mbajnë instrumente, të cilat numërohen si kapital i kompanive të sigurimit. Qeveria duhet të heqë mbrojtjen e KSD ndaj borxhit të subordinuar. Gjithashtu, kredimarrësit duhet të ndalohen të blejnë borxhin e subordinuar të kredidhënësve të tyre.

4.9.3 Sigurimi i depozitave

Pas rikapitalizimit të bankave, qeveria duhet të eliminojë mbrojtjen e detyrimeve (jo-depozita) të bankave dhe duhet të kufizojë mbrojtjen e depozitave deri në 10 milionë jen për klient. Premiumet e rregulluara sipas rrezikut për sigurimin e depozitave duhet të vendosen menjëherë. Sistemet e kursimeve postare dhe të sigurimit të jetës përfaqësojnë një çrregullim të konkurrencës në tregjet financiare japoneze dhe duhet të privatizohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Në terma afatshkurtër, sistemi i kursimeve postare duhet të jetë subjekt i taksimit, primeve të sigurimit të depozitave dhe i rezervave të detyruara.

4.10. Rregullimi i tregjeve të letrave me vlerë evropiane: Raporti i Lamfalussy 26

Futja e monedhës unike po krijon presione ndaj standarteve të përbashkëta të rregullimit financiar, sidomos në lidhje me tregjet e letrave me vlerë. Krahasuar me SHBA, tregjet e kapitalit në Evropë duken shumë të vogla, nuk janë konkurruese sa duhet dhe shumë të copëzuara. Përparimi drejt një tregu unik në shërbimet financiare, pengohet nga prania e 15 sistemeve të ndryshme kombëtare të legjislacionit financiar dhe nga procedurat e ngadalta dhe të ngurta të Komunitetit Evropian. Raporti i Lamfalussy, domethënë raporti përfundimtar i Komitetit të Njerëzve të Zgjuar mbi Rregullimin e Tregjeve të Letrave me Vlerë Evropiane, i publikuar në 15 shkurt 2001 dhe i adoptuar nga Këshilli Evropian në Stokholm më 23 mars 2001, paraqet një diagnozë të vlefshme mbi çështjet dhe problemet. Në qendër të këtyre shqetësimeve qëndrojnë vështirësitë në zbatimin e reformave nëpërmjet rregullatorëve kombëtarë, të cilët duke pasur parasysh rrezikun e brendshëm për mënjanim të përforcuar nga përgjegjësitë e tyre përpara politikëbërësve kombëtarë, kanë tendencë të shfrytëzojnë paqartësitë në Direktivat e BE në favor të bursave kombëtare. Çështja qëndron në atë që propozimi i ri të përballlet me sfidën e kapërcimit të inercisë.

Në këtë deklaratë, KEHRRF identifikon mungesat e mëposhtme në raport:

- Nuk mund t'i arrijë objektivat në kohën e përcaktuar.
- Procedurat janë të ngatërruara pa qenë nevoja.
- Ngatërresat politike dhe institucionale përbëjnë një shqetësim serioz.

Në mënyrë që të rregullohen këto mungesa Komiteti rekomandon si vijon:

- Një procedurë të thjeshtuar legjislative, e cila përfshin një e jo dy komitete për letrat me vlerë.
- Përgjegjshmëria përpara Parlamentit Evropian duhet të jetë një veçori qendrore e këtij procesi legjislativ, duke përfshirë nivelin 2.
- Duhet të bazohet në forcat e tregut dhe në vetërregullim.

4.11. Reformimi i rregulloreve për kapitalin e bankave 27

Kjo deklaratë parashtron parimet në të cilat duhet të bazohet një sistem rregullativ për kapitalin e bankave; tregon se si Akordi i Ri i Bazelit për Kapitalin nuk i arrin këto standarde, dhe; jep rekomandime të cilat do të përmirësonin dukshëm rregullat për mjaftueshmërinë e kapitalit. Këto rekomandime bazohen në besimin e fortë se rregullatorët nuk janë në një pozicion më të mirë për të vlerësuar rrezikun sesa pjesëmarrësit në tregjet financiare.

4.11.1. Parimet

Të gjitha propozimet për të reformuar ose për të përmirësuar rregullimet e kapitalit duhet, sipas mendimit tonë, t'u përmbahen parimeve të mëposhtme. Ndërkohë që ne njohim se vënia në funksion e këtyre parimeve duhet të ketë parasysh kushtet specifike në vende të ndryshme, ato megjithatë duhet të drejtojnë zhvillimet dhe zbatimet e rregullimeve të kapitalit në të gjitha vendet.

1. Bankat duhet të mbajnë një nivel kapitali, i cili është i mjaftueshëm për to:
 - (a) ulin mundësinë që një bankë të mos jetë në gjendje të kryejë pagesat në një nivel, i cili është në përputhje me një sistem bankar të qëndrueshëm;
 - (b) imunizimi i taksapaguesve ndaj humbjeve të shkaktuara nga reklamues bankarë ndaj garancive të mbështetura nga qeveria në rastin e falimentimit të bankave; dhe
 - (c) të bashkojë interesat e pronarëve dhe administratorëve të bankave me ato të reklamuesve të pasiguruar në lidhje me rrezikun e marrë përsipër nga bankat.
2. Kapitali duhet matur në mënyrë të tillë që të maksimizojë përdorimin e informacionit të tregut.
3. Niveli i kapitalit dhe i ekspozimit ndaj rrezikut duhet të shpërndalet publikisht dhe shpesh.
4. Mbikëqyrja bankare duhet të administrohet nga rregullatorë kompetentë, të cilët janë të pavarur nga presionet politike dhe të industrisë bankare, dhe të cilët janë të përgjegjshëm publikisht.
5. Rregullat dhe mbikëqyrja duhen hartuar në mënyrë të tillë që të përmirësojnë disiplinën në treg.
6. Rregullat duhen hartuar në mënyrë të tillë që të identifikojnë dhe të informojnë mbi kredi të lidhura me njëra-tjetrën, dhe të ofrojnë mbrojtjen e duhur.

7. Rregullat duhet të përfshijnë një mekanizëm efektiv për fuqizimin e rregullimit të kapitalit.

4.11.2. Mungesat e propozimit të Bazelit në lidhje me parimet e rregullimit të kapitalit

1. Propozimi i Bazelit nuk do t'i bëjë bankat që të mbajnë një nivel të mjaftueshëm kapitali sipas ekspozimit të tyre ndaj rrezikut.

Përdorimi i renditjeve të brendshme të bankave krijon shumë mundësi për të luajtur me rregullat. Akordi i propozuar u lejon bankave që të përdorin renditjet e brendshme në kushte të caktuara, të cilat janë subjekt vlerësimi dhe pranimi nga autoriteti mbikëqyrës. Ky vlerësim është i komplikuar, për shkak të praktikave të bankave gjatë vlerësimit të rrezikut dhe varion mjaft nga vendosja intuitive e kredive në kategori rreziku ndaj përdorimit të modeleve të sofistikuar të vlerësimit të rrezikut. Aftësia e mbikëqyrësve për të parandaluar luajtjen, me siguri që do të jetë e kufizuar megjithë mbikëqyrjen më të intensifikuar të rekomanduar në propozim. Kjo është e rëndësishme sepse bankat kanë incentiva për të minimizuar mjaftueshmërinë e kapitalit për një nivel të caktuar rreziku ekonomik.

Renditjet e jashtme nuk mund të përdoren për të matur si duhet rrezikun, për shkak të kredive bankare. Në lidhje me renditjet e jashtme, paraqiten një numër vështirësish. Agjencitë e listimit kanë pak eksperiencë në renditjen e rrezikut të kredimarrësve; renditja e çdo kredimarrësi do të ishte mjaft e kushtueshme; dhe historiku i agjencive sugjeron që ato kanë qenë më të sakta në konfirmimin e rrezikut se sa në diagnostikimin e tij. Për më tepër, aty ku renditjet janë përdorur me qëllimin e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit, ka shumë mundësi që agjencitë e listimit do të jepnin renditje të paragjykuara.

Një shqetësim tjetër ka të bëjë me atë se firmat dhe bankat në ekonomi në zhvillim mund të ndikohen negativisht nga ndonjë ulje e papritur e renditjes kombëtare.

2. Propozimi nuk kërkon që kapitali të matet bazuar në vlerën e tregut.
3. Megjithëse rekomandimet dhe kërkesat për informacion shtesë janë të dëshirueshme, propozimi nuk shkon deri aty sa të përmirësojë rolin e disiplinës së tregut në përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Komiteti i Bazelit bazohet tek informacioni i dhënë për të krijuar disiplinë në treg. Sidoqoftë, një disiplinë efektive e tregut kërkon jo vetëm që informacioni për tregun të jetë i pranishëm, por edhe që pjesëmarrësit në treg të kenë motivim për të vepruar sipas informacionit. Për sa kohë që depozituesit dhe kreditorë të tjerë të bankave, janë në mënyrë të shprehur ose jo të mbrojtur ndaj humbjeve, ata do të jenë më pak të interesuar të kërkojnë informacion në lidhje me rreziqet ose me humbjet, dhe për të vepruar mbi informacionin që u jepet.
4. Numri dhe kompleksiteti i rregullave të propozuar do ta bëjë akoma më të vështirë që rregullatorët dhe mbikëqyrësit të jenë përgjegjës për gjykimet e tyre në lidhje me rrezikun e bankave dhe mund të rezultojë në rritje të lëshimeve nga rregullatorët.
5. Rregullatorët duhet të trajtojnë në mënyrë më urgjente konfliktet e interesit, të cilat kanë shkaktuar shpesh falimentime të bankave në shumë vende, sidomos

problemin e “kredive me mik” – kredi për njerëz të brendshëm, askionerë kryesorë dhe personave të lidhur me ta.

6. Megjithëse Komiteti i Bazelit duket sikur nuk e konsideroi që detyrimi të ishte në mandatin e tij, duhet të jetë e qartë se asnjë regjim i rregullimit të kapitalit, nuk mund të jetë efektiv pa një mekanizëm të fuqishëm detyrues.

4.11.3. Rekomandime

Rekomandimet që vijojnë, të cilat duhet të adoptohen sipas situatave të vendeve të veçanta reflektojnë shqetësimet tona mbi dy çështje bazë. E para ka të bëjë me nevojën për një regjim efektiv detyrues. E dyta, ka të bëjë me faktin që vendosja e rregullave bazuar në renditjet e brendshme, nuk ka transparencë të mjaftueshme, gjë që forcon nevojën për masa shtesë, të cilat do të përmirësonin disiplinën në treg.

Kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit kërkojnë zbatim efektiv. Në SHBA, për shembull, një sistem i njohur si veprim i menjëhershëm korrigjues përpiket të minimizonim sanksionet që tregu do të vendoste në mungesë të një rrjete sigurie qeveritare. Një mekanizëm efektiv detyrues i bazuar në këtë model do të përfshinte trajtat që vijojnë:

- (1) zona të shumëfishta kapitali me sanksione më të forta progresive;
- (2) një rregull për mbylljen e ekuitetit kur ai është akoma mbi zero; dhe
- (3) zgjidhja e falimentimeve me koston më të ulët për taksapaguesit.

Sasia e duhur e kapitalit duhet të përafrohet me atë që bankat do të mbanin në rast të mungesës së një rrjete sigurie të sponsorizuar nga qeveria. Kështu, përveç raporteve të Bazelit bazuar në rrezik, standardet përkatëse të kapitalit duhet të përfshijnë një raport të “forcës”, bazuar në mjetet totale (mjete të bilancit dhe ato jashtë tij).

Në mënyrë që të forcohet disiplina në treg, ne rekomandojmë që bankat në vendet e industrializuara të emetojnë një sasi minimale borxhi të besueshëm të subordinuar, të pasiguruar. Mbajtësit e një borxhi të tillë janë të ndjeshëm dhe në një pozicion unik për të monitoruar rrezikun e kreditit. Prandaj, rregullat e Bazelit për kapitalin duhet të suplementohen me sinjale nga këta kreditorë të pasiguruar. Për ta inkurajuar këtë gjë, ne rekomandojmë që ndryshimet ndërmjet kapitalit të Tier I dhe atij të TierII të hiqen.

Megjithëse bankat përballen me një shkallë disipline të tregut nga tregu i aksioneve në shumicën e vendeve të industrializuara, informacioni i dhënë nga çmimet e aksioneve bëhet më pak i besueshëm në mënyrë progresive, ndërkohë që bankat i afrohen momentit kur nuk janë në gjendje të kryejnë pagesat.

Ky propozim mbi borxhin e subordinuar mund të zbatohet në mënyrë eksperimentale në faza në mënyrë të tillë që të minimizohen kostot dhe të lejojnë për rishikime të efektivitetit. Së pari, kjo kërkesë mund të kufizohet tek institucionet e mëdha, borxhi i të cilave tregtohet në mënyrë aktive. Pastaj, sinjalet e tregut nga borxhi i subordinuar nuk ka nevojë që të mandatojnë ndonjë veprim mbikëqyrës të kërkuar; sidoqoftë, interesat e këtij borxhi do të japin informacion ndihmues për tregun dhe për mbikëqyrësit.

Në rastin e tregjeve në zhvillim, përdorimi i suksesshëm i borxhit të subordinuar si kapital dhe si sinjal i fuqisë së bankës, mund të kufizohet nga mungesa e një tregu likuid dhe të zhvilluar të kapitalit. Sidoqoftë, kjo nuk duhet t'i pengojë këto vende për të

identifikuar dhe zhvilluar sinjalet e fuqisë së bankave – për shembull, duke i inkurajuar bankat që të ofrojnë në mënyrë të besueshme çertifikata të pasiguruara depozitash.

4.12. Rithellimi i tregut evropian të letrave me vlerë.

Vala aktuale e bashkimeve ndërmjet bursave të letrave me vlerë ka pasoja goditëse për strukturën e kleringut të tyre në Evropë. Deri vonë, sistemet e kleringut kanë funksionuar si utilitete, që i kanë shërbyer nevojave kombëtare brenda tregjeve të segmentuara të kapitaleve dhe të mbrojtura nga shteti, në Evropë. Këto sisteme tashmë po adoptohen ndaj nevojave të një tregu në integrim, të letrave me vlerë. Një pyetje kryesore është ajo se çfarë roli duhet të kenë autoritetet evropiane në procesin e ristrukturimit?

Fakti se përfitimi nga ekonomitë e shkallës dhe efekte të rrjeteve, të cilat karakterizojnë funksionet e kleringut nuk po shfrytëzohen si duhet në Evropë, gjen njohje të gjerë. Kufizimet ndaj konsolidimit të kleringut dhe finalizimit të transaksioneve, të cilat zakonisht kryhen nga Depozituesit Qendrorë të Letrave me Vlerë (DQLV), shkon përtej atyre që ndodhin për shkak të veprimeve çrregulluese qeveritare në fushat e rregullimit dhe taksimit. Ato rrjedhin në mënyrë thelbësore nga struktura aktuale e tregjeve, e cila përcaktohet nga integrimi vertikal i platformave të tregtimit dhe finalizimit në një numër qendrash të mëdha të tregut – ndoshta kryesisht në Gjermani, ku Bursa Gjermane kontrollon gjysmën e kleringut dhe ka shprehur një dëshirë të hapur për ta pasur të sajën. Krijimi i “qendrave vertikale” ka efektin jo vetëm të bllokimit të bashkimeve ndërmjet shteteve të DQLV, por krijon pengesa për konkurrencën ndërmjet bursave dhe platformave të tregtimit. Krijimi i një barriere të tillë është në fakt një motivim për krijimin e sjelljeve të tilla: bursa të cilat kanë DQLV mund të hyjnë në tregje ku bursat e tjera e kanë tepër të kushtueshme dhe operatorët e DQLV të cilët dëshirojnë të konkurrojnë, për përcjelljen e urdhërave të të njëjtave letra me vlerë.

Shqetësime të tilla kanë çuar në propozime, sidomos nga Kryetari i Bursës së Londrës, Don Cruickshank, që Komisioni Evropian të eliminojë “qendrat vertikale” dhe të “eksplorojë se si mund të detyrojë Evropën të përdorë një DQLV”. (29) Qëllimi është që të krijohet një monopol i rregulluar fuqishëm i organizuar sipas Korporatës Amerikane për Kleringun dhe Trustin Depozitor (KAKTD), një organizatë e mandatuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë dhe i Shkëmbimeve pasi i detyroi bursat amerikane që të eliminonin nga përbërja e tyre degët e finalizimit, para tre dekadash.

KEHRRF nuk beson se t’i japësh të drejtën Komisionit për të krijuar një industri utiliteti të tillë gati të nacionalizuar, është në interesin e investitorëve apo të korporatave që emetojnë borxh. Duke pasur parasysh hapin e shpejtë të përparimit teknologjik në sektorin e letrave me vlerë, asnjë organizëm qeveritar nuk është në gjendje të zëvendësojë parashikimin tregtar ose teknologjik për stimujt kritikë të forcave konkurruese të tregut.

Sidoqoftë, ne besojmë se krijimi i qendrave vertikale nuk është një lloj si të krijosh një treg unik të letrave me vlerë në Evropë, i cili karakterizohet nga konkurrencë ndërmjet bursave të vendeve të ndryshme dhe ofrues të tjerë të shërbimeve të tregtimit. Ne besojmë që përpjekjet në nivel evropian për të rregulluar politikën e aksesit dhe taksat e DQLV-ve të kontrolluara nga bursat kombëtare, të cilat janë gati monopole në lidhje me letrat me vlerë të listuara prej tyre, nuk do të jenë efektive. Komisioni Evropian ka sugjeruar së fundi që pengesat ndaj konkurrencës, të krijuara nga qendrat vertikale të

pakësohen duke u dhënë pjesëmarrësve në treg të drejta aksesi në DQLV sipas zgjedhjes së tyre. Efektiviteti i këtyre të drejtave sidoqoftë do të ulej nga përjashtime të nevojshme dhe kushte të lejuara nga Komisioni. Për më tepër, regjimi i propozuar nga Komisioni mund të çonte në përfshirjen e DQLV në vendime të vendosjes së çmimeve.

Kështu që KEHRRF bën thirrje për një regjim tjetër rregullator me synim që (a) të maksimizohen motivet për DQLV që të përdorin ekonomitë e shkallës dhe efektet e rrjeteve të shërbimeve të tyre; dhe (b) të lehtësojë konkurrencën e hapur dhe direkte ndërmjet platformave tregtuese për letra me vlerë evropiane.

Ne propozojmë që të ndalohen bursat evropiane nga pronësia kontrolluese në DQLV. Kjo mund të kërkojë që disa bursa të çlirohen nga prona të tyre në DQLV, por nuk do të përfshinin Komisionin ose ndonjë organizëm tjetër qeveritar në rregullimin e përditshëm të sjelljes së bursave në lidhje me marrëdhëniet e tyre tregtare me DQLV dhe me bursa të tjera.

Ne parashikojmë që një veprim i tillë do të nxiste një konsolidim ndërmjet vendeve të DQLV-ve në Evropë. Pasi DQLV të mos përdoren më nga bursat si barriera ndaj konkurrencës, ato do të detyrohen të konsiderojnë bashkimet si metodë mbijetese: ato që nuk marrin pjesë në procesin e konsolidimit mund ta gjejnë shpejt veten e tyre në disavantazh konkurrues ndaj rivaleve që kryejnë veprime të mëdha me kosto të ulët. Këtu mund të heqim paralele të qarta me industrinë globale të kujdestarisë, e cila ka parë konsolidim të vazhdueshëm dhe ulje kostosh.

Prandaj, ne nuk shikojmë ndonjë nevojë të parandalimit të konsolidimit të këtij tregu nëpërmjet vendosjes së një DQLV të vetme për Evropën si propozohet nga z. Cruickshank. Do të ishte më mirë që industria të reformohej në bazë të nevojave dhe të motiveve të tregut.

Ne mendojmë se propozimi ynë ofron parashikimin më të mirë për të siguruar që tregu i DQLV është konkurrues. Sidoqoftë, në rast se me kalimin e kohës konsolidimi do të çonte drejt monopoleve – aktualisht diçka e largët – do të ishte e përshtatshme që të konsideroheshin rregulla mbrojtëse.

Ne gjithashtu, besojmë se regjimi i BE për “njohje reciproke” e kombinuar me “kontrollin kombëtar” i përshtatet në mënyrë optimale konsolidimit për shkak të konkurrencës të industrisë së DQLV. DQLV konkurruese do të kenë motivim maksimal për t'u vendosur në juridiksione kombëtare rregullatore, të cilat do t'i lejonin ato që të operonin në maksimumin e eficiencës: për shembull juridiksionet në të cilat shenjtësia e marrëveshjeve mbrojtëse nuk ka lidhje me procedurat e falimentimit do të kenë përparësi ndaj atyre, të cilat nuk kanë mbrojtje të tilla. Kjo do t'i çojë DQLV drejt juridiksioneve që kanë mbrojtje dhe do të inkurajojë qeveri të tjera për të reformuar ligjet e tyre të falimentimit.

4.13. Tentativat për blerje në Evropë (30)

Tregjet evropiane të kapitalit po integrohen gjithnjë e më tepër si rezultat i përdorimit të euros, i zgjerimit të investimeve ndërkombëtare të letrave me vlerë, i zhvillimeve në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit dhe në harmonizimin e rregullave për tregjet e kapitalit. Ky harmonizim është rezultat i përpjekjeve të Komisionit Evropian për të krijuar një kuadër të përbashkët rregullator për tregjet e letrave me vlerë dhe bankingun në BE si dhe i konkurrencës ndërmjet sistemeve ligjore kombëtare për korporatat.

Në këtë kontekst, ligjet e BE për tentativat për blerje konsiderohen jetësore në lidhje me objektivin e përmirësimit të konkurrueshmërisë së Evropës, sidomos në lehtësimin e konsolidimit të industrisë ndërmjet shteteve. Qëllimi i Komisionit është që të krijojë një treg të zhvilluar për blerje, duke krijuar mekanizmat për blerje dhe ndryshimet në administrimin e firmave të drejtuara keq, dhe duke pakësuar qëllimin e administratorëve për të marrë përfitime private. Dështimi i sigurimit të shumicës për draftin e fundit të BE, të Direktivës për Blerjet në Parlamentin Evropian është konsideruar si hap prapa për procesin e harmonizimit. Në përgjigje ndaj këtij problemi, Komisioni Evropian krijoi një Grup të Nivelit të Lartë me Ekspertë të Ligjeve për Kompanitë për të propozuar zgjidhje ndaj një numri çështjesh të pazgjidhura.

KEHRRF ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme, dëshirën e arritjes së një tregu më të integruar kapitalesh brenda BE. Ne mendojmë se një program për harmonizimin e rregullave për tregjet e kapitalit është i qenësishëm për t'u dhënë investitorëve të BE-së akses ndaj letrave me vlerë në të gjitha vendet anëtare me kushte të barabarta. Përcaktimi i ligjit të korporatave, sidoqoftë, duhet t'u lihet vendeve anëtare sipas parimit të varësisë. Kurdo që BE nuk i është përmbajtur këtij parimi në fushën e ligjit për korporatat, rezultatet ose nuk kanë qenë në vazhdimësi ose kanë qenë të dëmshme (për shembull, vendosja e një regjimi të ngurtë dhe të shtrenjtë të kapitalit të detyruar në Direktivën e Dytë për Ligjin mbi Korporatat). Tashmë ka fakte të bollshme që është e preferueshme të lejohen korporatat të mbajnë një nivel fleksibiliteti duke i lënë strukturat e tyre të konkurrojnë ndërmjet vendeve anëtare.

Në këtë deklaratë, KEHRRF rekomandon që BE të adoptojë ndryshimet dhe shtesat në vijim në propozimin për një Direktivë të 13, në lidhje me rregullat për tentativat për blerje kompanish, si shtesë e atyre të rekomanduara në datë 10 janar 2002 nga Grupi i Nivelit të Lartë me Ekspertë të Ligjeve për Kompanitë:

1. “Rregulli i depërtimit” i cili deklaron se një blerës merr në kontroll një kompani pasi ka siguruar 75 për qind të kapitalit rrezikmbajtës, duhet të modifikohet nga një klauzolë “mbrojtëse” që u lejon pronarëve të një korporate pesë vjet për të adoptuar statutet e tyre përpara se ky rregull të hyjë në fuqi.
2. Të përfshihet një rregull në Direktivën e Blerjeve, e cila do t'u kërkonte vendeve anëtare të nxjerrin rregullore që do t'i lejonin dhe inkurajonin gjykatat e tyre, që të ekzaminonin dhe të zhvlerësonin disa rregullime kontraktuale, të cilat i shërbejnë qëllimit parësor të pengimit të blerjeve të kompanive.
3. Ndërkohë që ne e konsiderojmë mbrotjen e aksionerëve të vegjël një veçori të rregullave mbi letrat me vlerë dhe ligjit për kompanitë, kjo mund të arrihet në mënyrë efektive në disa drejtime dhe jo vetëm nëpërmjet rregullave detyruese. Për më tepër, efektet e rregullave detyruese janë të paqarta dhe mund të ndryshojnë midis vendeve. Prandaj, ne propozojmë që Direktiva nuk duhet të parashikojë blerje të detyruara por rregulla të detyruar për blerjet, të cilat duhet të jenë subjekt i parimit të varësisë.

4.14. Reformat në procesin e ristrukturimit të borxhit ndërkombëtar të qeverive (31)

Takimet vjetore të FMN dhe BB të shtatorit 2002 theksuan dy propozime për të reformuar procesin e ristrukturimit të këtij borxhi: klauzolat e veprimit kolektiv (KVK) dhe një mekanizëm të ristrukturimit të borxhit të jashtëm të qeverive (MRBJQ), i ashtuquajtur i trajtim statutor për reformë. As FMN, as kritikët e tij nuk besojnë se këto masa do të jenë të mjaftueshme për të minimizuar mundësinë e krizave të borxhit të jashtëm ose për të siguruar se ato zgjidhen në mënyrën e duhur. Megjithatë, propozimet kanë tërhequr vëmendje të madhe dhe kërkojnë analizë të kujdesshme. Komitetet në Hije besojnë që propozimet e FMN-së shkojnë shumë larg por jo dhe aq në disa drejtime të tjera. Ato shkojnë shumë larg në lidhje me refomat urgjente të sugjeruara për zgjidhjen e procesit të borxhit të jashtëm. Në këtë kontekst, Komitetet në Hije janë në favor të një trajtimi më gradual, i cili fillon duke forcuar metodat ekzistuese kontraktuale për zgjidhjen e problemeve me borxhet. Propozimet nuk shkojnë larg sa duhet në lidhje me reformimin e politikave të FMN-së, të cilat krijojnë motivim për të vonuar njohjen dhe zgjidhjen e borxheve të paqëndrueshme.

Një objektiv qendror i propozimeve për reformë është për të lehtësuar konfliktet ndërmjet kreditorëve që ndodhin shpesh gjatë procesit të rinegocimit të borxhit. Në veçanti, borxhi në zotërim nga një minoritet kreditorësh mund të vonojë zgjidhjen e tij dhe të pengojë debitorët në përdorimin e burimeve ndërkombëtare të kreditit. Komitetet në Hije besojnë që ky problem mund të adresohet nga adoptimi i përgjithshëm i KVK, i cili do të vendoste rregullin e shumicës mbi kreditorët e bonove. Komitetet gjithashtu, besojnë që ky qëllim mund të arrihet nga veprimet e vullnetshme të kreditorëve dhe debitorëve të mbështetur nga përdorimi i incentivave për kreditorët dhe debitorët për të përdorur KVK. Në këtë pikë, Komitetet nuk janë dakord për përdorimin e trajtimit statutor për zgjidhjen e çështjeve të borxheve. Sidoqoftë, në rast se përdorimi i vetmuar i KVK rezulton i papërshtatshëm pas një periudhe prove, një trajtim statutor mund të rikonsiderohet.

4.15. Qeverisja e korporatave në Evropë (32)

Ngjarjet e fundit në SHBA, si rasti Enron dhe WorldCom si dhe vështirësitë në kompani evropiane si Vivendi, kanë sjellë në qendër të vëmendjes çështjet e qeverisjes së korporatave. Në SHBA, çështja Enron ka shkaktuar një numër iniciativash ligjore (si akti Sarbanes – Oxley i korrikut të vitit 2002). Nevoja për qeverisje më të mirë të korporatave në BE dhe metodat për ta arritur këtë janë subjekt i kësaj deklaratë nga KEHRRF. Deklarata përfshin raportin e nëntorit të vitit 2002 nga Grupi i Nivelit të Lartë me Ekspertë të Ligjeve për Kompanitë i drejtuar nga Jaap Winter (Grupi Winter). Një motivim (33) për raportin e tyre është “kordinimi dhe forcimi i përpjekjeve të ndërmarra nga dhe brenda vendeve anëtare, për të përmirësuar qeverisjen e korporatave”. Objektiva të menjëhershëm të Grupit Winter janë përmirësimi i mbrojtjes së aksionerëve dhe rivendosja e konfidencës në sistem, i cili ishte tronditur nga ngjarjet e fundit. Por, Grupi Winter gjithashtu u fokusua në përmirësimin e eficiencës dhe të konkurrueshmërisë së firmave të BE, me qëllim dhënien e ndihmës në zhvillimin e Tregut Unik dhe lehtësimin dhe fuqizimin e investimeve ndërmjet vendeve.

Trajtimi nga KEHRRF i një numri çështjesh në qeverisjen e korporatave në BE ka dy përmasa. Së pari, ne kërkojmë të vlerësojmë nëse vetërregullimi nga firmat është i mjaftueshëm për të siguruar qeverisje të shëndetshme të korporatave ose nëse ka nevojë për rregullim nëpërmjet statuteve. Së dyti, në rastin kur vetërregullimi nga firmat ose nga

sektori privat është i pamjaftueshëm, ne përpiqemi të vlerësojmë nëse harmonizimi ligjor në BE ose rregullat kombëtarë janë veprimet më të mira rregullatore. Ne gjithashtu theksojmë ndryshimet ekzistuese në qeverisjen e korporatave ndërmjet vendeve dhe se nuk ka një “tip më të mirë” të qeverisjes ndaj së cilës Evropa duhet të lëvizë, nëpërmjet rregullimeve sesa ndaj forcave të tregut. Një pasojë është se vendet e BE nuk duhet thjesht të jenë në një vijë me trajtimin amerikan por se duhet të ketë një marrëveshje të gjerë të rregullave BE – SHBA.

4.15.1. Procedura për përmirësimin e qeverisjes së korporatave në BE

Në ligjet për kompanitë dhe për fusha të tjera që prekin qeverisjen e korporatave brenda BE ka diversitet të madh dhe ndryshimet do të rriten më tepër me zgjerimet në vitet në vijim. Prandaj ka rëndësi të madhe për BE që të zhvillojë procedura për reformë në qeverisjen e korporatave të cilat kanë parasysh ndryshimet ndërmjet vendeve si dhe ndryshimet në fushat ligjore që kanë të bëjnë me qeverisjen e korporatave.

Në lidhje me procedurat, raporti Winter rekomandon që Komisioni duhet t’u japë përparësi përgatitjes së një “Plani Veprimi për Ligjet për Kompanitë i cili vendos një axhendë për BE, me prioritet për iniciativa rregullatore...”, dhe për të “vendosur një strukturë të përhershme për t’i siguruar Komisionit këshillim të pavarur mbi iniciativat e ardhshme rregullatore...”. Grupi Winter është mjaft qartë i frymëzuar nga iniciativat e Komisionit në sektorin e shërbimeve financiare për të zhvilluar një plan veprimi për shërbimet financiare dhe nga raporti Lamfalussy. Ne jemi të shqetësuar që planet e veprimit si dhe strukturat e përhershme këshilluese, do të mund të kenë një paragjykim automatik ndaj harmonizimit. KEHRRF e ngre këtë çështje në deklaratën nr. 10.

KEHRRF rekomandon që Komisioni dhe institucione të tjera të BE të mbajnë pozicione të qarta mbi (i) parimet për përdorimin e harmonizimit ndaj varësisë së legjislacionit dhe rregullimit; dhe (ii) parimet për përdorimin e direktivave detyruese ndaj rekomandimeve dhe metodave të tjera jodetyruese, duke përfshirë iniciativa private, për arritjen e standardeve të përbashkëta.

Komiteti beson se përpjekjet për harmonizim duhet të fokusohen në legjislacion që përmirëson lëvizshmërinë i cili eliminon pengesa të qarta ndaj lëvizshmërisë, si dhe diskriminim me miratim qeveritar të firmave dhe individëve nga vende të ndryshme. Lëvizshmëria dhe mosdiskriminimi çojnë në konkurrencë ndërmjet strukturave kombëtare institucionale dhe prandaj me kalimin e kohës mund të çojnë në një shkallë harmonizimi, për shkak të forcave të tregut. Nga kjo pikëpamje, raporti Winter thekson me të drejtë që pengesat për zgjedhjen e juridiksionit për korporatat, nuk duhen pranuar. Pengesa të tilla dobësojnë konkurrencën në fushën e ligjit për kompanitë.

Kritere shtesë për harmonizim pozitiv përfshijnë një “garë deri në fund”. Megjithatë, ka pak fakte të garave të tilla në fushën e ligjit për kompanitë dhe qeverisjes së korporatave në përgjithësi. Për më tepër, një rast për harmonizim mund të bëhet për përmirësimin e mekanizmit të konkurrencës, për shembull, në fushën e dhënies së informacionit. Ka gjithashtu, fusha të ligjit të kompanive ku konkurrenca ndërmjet strukturave ligjore dhe rregullatore, funksionon shumë ngadalë. Forcat e tregut mund “të ndihmohen” nga iniciativat e BE, për shembull, në rastin e konfliktit të interesit ndërmjet aksionerëve dhe administratorëve.

Shtimi i përdorimit të rekomandimeve nga BE, mund të shpejtojë adoptimin vullnetar të “praktikave të mira” (vetërregullim), dhe këto praktika mund të lejohen të variojnë ndërmjet vendeve të ndryshme. Rekomandimet gjithashtu, do të bënin të mundur “testimin” e rregullave dhe të legjislacionit në vendet anëtare, që i adoptojnë ato përpara se direktivat të formulohen.

Duke qartësuar fokusin e strukturës së përhershme të përshkruar në Raportin Winter, KEHRRF sugjeron krijimin e një komiteti i cili përfshin përfaqësues nga të gjitha vendet e BE, për të kordinuar përgjigjet kombëtare ndaj iniciativës së SHBA, si Akti Sarbanes-Oxley që rrezikojnë aksesin e firmave evropiane në tregjet e letrave me vlerë amerikane. Koordinimi në Evropë në fusha të ndryshme ligjore dhe rregullative, mund të jetë gjithashtu, detyrë e këtij komiteti.

4.15.2. Çështje themelore në qeverisjen e korporatave në BE

Ne vazhdojmë me ilustrimin e një trajtimi të sugjeruar për BE, në lidhje me një numër aspektesh për qeverisjen e korporatave, duke theksuar marrëveshjet dhe mosmarrëveshjet e KEHRRF me trajtimin Winter, në lidhje me diskutimin e mësipërm.

Në rastin e dhënies së informacionit në lidhje me qeverisjen e korporatave, Grupi Winter propozon kërkesa për dhënie informacioni në vendet e BE për kompani të listuara (megjithëse rregullat e detajuara mund të vendosen në vendet anëtare) në lidhje me informacionin mbi elemente-kyç të rregullave të qeverisjes së korporatave në një deklaratë vjetore, pagesës për drejtorët, kostot e skemave të kompensimit, pavarësinë e drejtorëve ndaj kualifikimeve të tyre dhe strukturat e grupeve. Komiteti sugjeron që dhënia e informacionit është një rast kur vetërregullimi nga firmat ka dëshmuar se ka qenë i mjaftueshëm, dhe ne jemi dakord që megjithëse nga direktivat mund të përcaktohen vija të përgjithshme, detajet u duhen lënë rregullave kombëtar të cilët funksionojnë nëpërmjet statuteve ose marrëveshjeve vullnetare. KEHRRF konsideron se fokusi në dhënien e informacionit për strukturat e qeverisjes së korporatave, duke përfshirë aksionerët dhe lidhjet e tyre me kompaninë, është i mirëpritur dhe sygjeron se rregullat mund të përfshijnë edhe “kompani të hapura”. Vlerësimi i opsioneve të aksioneve dhe inkorporimi i tyre në deklaratat mbi fitimet apo humbjet, duhet të jetë përparësi për Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Komiteti vë re se dhënia e informacionit mund të ndërmerret fare lehtë, me qëllim për të keqinformuar, duke sugjeruar që një format apo model i gatshëm është i nevojshëm për të lehtësuar krahasimin ndërmjet vendeve.

Në lidhje me votimin, Grupi Winter propozon rregullat të aplikueshme në BE në lidhje me informacionin mbi votimin, mbi takimet e aksionerëve dhe votimin ndërmjet vendeve, si dhe aksesin në takimet e aksionerëve. Aksionerët që janë në pakicë duhet të kenë të drejtën të kërkojnë hetime speciale. Votimi është përsëri një rast ku vetërregullimi i vetëm ka rezultuar i pamjaftueshëm; rregulla të aplikueshme në të gjithë BE për votimin ndërmjet vendeve dhe aksesin në takimet e aksionerëve, sigurisht “përmirësojnë lëvizshmërinë” dhe Komiteti e mbështet. Ata shkojnë së bashku me rritjen e investimeve ndërmjet vendeve pas EMU. E drejta e sugjeruar për hetime speciale për firma të hapura dhe të mbyllura duhet rekomanduar njëlloj,; do të ishte një ndryshim radikal në disa vende të BE-së.

Grupi Winter propozon adoptimin e një rekomandimi të BE, i cili do të forconte rolin e drejtorëve të pavarur gjatë autitimit, emërimit dhe shpërblimit të komiteve si dhe të

Bordit. Kriteret për pavarësinë e drejtorëve përshkruhen. KEHRRF është gjerësisht dakord me fokusin ndaj drejtorëve të pavarur dhe përgjegjësive të tyre, si dhe me mënyrën e propozuar të veprimit. Në anën tjetër, rregullat e fortë për kualifikimet e anëtarëve të bordit dhe përgjegjësitë e tyre, mund të shkurajojnë individë të kualifikuar për të qenë anëtarë bordi dhe mund të shkaktojnë vështirësi në vende, ku përfaqësuesit e punëtorëve dhe të kreditorëve janë normalisht anëtarë të bordit. Komiteti do të sugjeronte që të formulohej një përkufizim i thjeshtë për një drejtor të pavarur nëpërmjet një testi i cili mundohet të përjashtojë konfliktet e interesit gjatë marrëdhënieve me drejtorët ekzekutivë dhe aksionerët kryesorë (në qoftë se ka). Për më tepër, Komiteti shkon përtej Grupit Winter dhe rekomandon një standart minimal për përfaqësimin e pavarur të bordit, të nivelit 30 për qind. Ky nivel përcaktohet poshtë atij prej 50 për qind për rastet kur ka aksionerë në bllok por mund të jetë më i lartë kur aksionet janë shumë të shpërndarë.

Grupi Winter propozon mbështetje të BE-së për rregullat kombëtare, në lidhje me përgjegjësitë e investitorëve institucionalë për të deklaruar politikat e investimeve dhe përdorimin e të drejtës së votës, ku strategjitë e votimit publikohen dhe votat individuale u jepen përfituesve të investitorëve institucionalë sipas kërkesës. Votimi nga investitorët institucionalë është përsëri një rast ku vetërregullimi në vetvete ka qenë i pamjaftueshëm, për shkak të pasivitetit përballë dështimeve të administruesve dhe mungesës së informacionit ndaj përfituesve dhe ne jemi dakord me rregullat e BE-së se sa me një rekomandim apo direktivë për shkak të traditave të ndryshme kombëtare. KEHRRF sugjeron që të mbulohen të gjithë institucionet, si fondet e pensionit, kompanitë e sigurimit të jetës dhe fondet e përbashkëta, të cilat zotërojnë mjete të mbrojtura nga detyrime që përfaqësojnë kursimet e përfituesve të tyre. Në lidhje me investitorë të tillë institucionalë ne do të shkonim më tutje se Grupi Winter dhe do të rekomandonim që institucionet të ishin të detyruara të publikonin një listë të votave të tyre në takimet e kompanisë, në mënyrë që përfituesit të kenë mundësi t'i ekzaminonjë. Për të qenë efektive, kjo me siguri që do të kërkojë marrjen e masave të përshtatshme për votimin si përshkruhet me lart. Kjo do të bënte me turp ata që votojnë në mënyrë pasive për administrim, dhe do të lejonte hetimin e konfliktit të interesit. Në anën tjetër, Komiteti është dakord që votimi i detyruar është i padëshirueshëm, për shkak se mund t'i detyrojë fondet të merrnin pozicione në zona ku nuk kanë ekspertizë. Për më tepër, megjithëse duket e pakundërshtueshme që t'u kërkohej investitorëve institucionalë të BE të tregojnë politikat e tyre të investimit, kjo mund të mbulohej më mire ng forma të tjera rregullative si përshembull Direktivat UCITS.

Grupi Winter sygjeron që të ketë rregulla të aplikueshme në të gjithë BE-në, për përgjegjësinë e anëtarëve të bordit për deklaratat financiare. Kjo çështje është një rast ku vetërregullimi në vetvete ka qenë i pamjaftueshëm, por KEHRRF vë në dyshim nëse është e nevojshme një Direktivë e BE-së, meqenëse përgjegjësia kolektive është pjesë e legjislacionit kombëtar. Komiteti është dakord me përgjegjësinë kolektive të bordit për deklaratat, siç është praktika aktuale në BE, se sa me përgjegjësi individuale si sugjerohet në SHBA.

4.16 Detyrat e mbikëqyrësve bankarë; administrimi i rrezikut apo stabiliteti i përgjithshëm (34)

Në këtë deklaratë, KEHRRF prezanton kundërshtime ndaj trajtimit tepër kompleks të draftit të Akordit të Ri të Bazelit mbi Kapitalin (Basel II). Ne e konsiderojmë si të fokusuar më shumë se sa duhet mbi rregullimin e administrimit të rrezikut nga bankat individuale. Gjithashtu, ne jemi kundër trajtimit të rrezikut operacional, çështjeve të influencuara politikisht rrotull kreditimit të SME-ve, konsiderimi të pakët të çështjes së prociklizmit dhe uljes së vëmendjes ndaj shtyllës së tretë, disiplinës në treg. Komiteti ofron rekomandime në lidhje me këto çështje dhe propozon që autoritetet evropiane të aplikojnë thelbin e trajtimit të avancuar të Basel II, vetëm për banka të mëdha dhe aktive në tregjet ndërkombëtare. Bankat e tjera do të kenë mundësinë e një trajtimi të thjeshtuar të standardizuar.

4.16.1. Rrethanat

Më 29 prill 2003 Komiteti i Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bnkare lëshoi një studim të tretë konsultativ dhe përfundimtar (CP3) për një Akord të Bazelit për Kapitalin. Akordi i ri duhet zbatuar në vendet e G10 para fundit të vitit 2006 për banka aktive në tregjet ndërkombëtare. Në vendet e BE-së, planet aktuale për Akordin aplikohen vetëm ndaj bankave dhe firmave investuese në një përditësim të Direktivës për Mjaftueshmërinë e Kapitalit (DMK III).

Akordi i Bazelit i vitit 1988 u aplikua në mënyrë konsistente në një numër të madh vendesh dhe kontriboi në rritjen e përgjithshme të kapitalit rregullator. Akordi ka disa dobësi të rëndësishme, si “trashësia” e peshave të rrezikut dhe arbitrazhi konsequent i rrezikut brenda kategorive të gjera të kredive. Propozime për rishikim u prezantuan në vitet 1999 dhe 2001. Basel II do të përbëhej nga tre shtylla: (1) kërkesat minimale për kapital; (2) kontrolli i mjaftueshmërisë së kapitalit nga mbikëqyrësit; dhe (3) disiplina e tregut nëpërmjet shpërndarjes publike të informacionit. Brenda shtyllës së tretë, tre trajtime u propozuan në lidhje me rrezikun e kreditit: (i) trajtimi i standardizuar ku peshat e rrezikut bazoheshin në vlerësime të jashtme të rrezikut, dhe dy trajtime të bazuara në renditjet e brendshme (RB); (ii) RB bazë; dhe (iii) RB i avancuar. Dy trajtimet e fundit do të ishin të hapura ndaj bankave “të sofistikuar”, në qoftë se do të merrej autorizim nga mbikëqyrësit. Propozimet gjithashtu përfshinë, të përcaktohej një kërkesë për kapital ndaj rrezikut operacional.

Gjatë procesit konsultues, u bënë lëshime për shkak të presioneve politike, të tilla si, kreditimi i SME-ve, ekspozimi i shitjes me pakicë, derivativet e kredive dhe kreditë për shtëpi. Përfshirja e mbikëqyrësve në procesin e brendshëm të administrimit të rrezikut në banka gjithashtu, është forcuar në CP3.

Në deklaratat e mëparshme, Komitetet në Hije e kanë kritikuar Akordin e Ri të propozuar, për kompleksitetin dhe arbitraritetin e tij. Akordi i ri u duk sikur i jepte rëndësi të kufizuar disiplinës së tregut dhe sikur nuk kishte një mekanizëm të përshtatshëm detyrues.

4.16.2. Kapja rregullatore, konkurrenca, dhe rreziku i përgjithshëm

Që rregullatorët “kapen” nga industria që ata rregullojnë është një fenomen i zakonshëm, që do të thotë se ata marrin objektivat e administruesve në firmat që ata kontrollojnë. Kështu, ata mund të humbasin nga sytë objektivat e tyre rregullatorë. Kapja rregullatore është mjaft serioze në industri si bankingu ku ka konflikt interesash ndërmjet objektivave

të firmës (për të maksimizuar fitimin) dhe objektivave të rregullatorëve (për siguruar mbrojtje për konsumatorët dhe të ruajnë stabilitetin e përgjithshëm).

Kompleksiteti i Basel II dhe roli që u është caktuar mbikëqyrësve kombëtarë e bëjnë gati të pamundur distancimin ndërmjet rregullatorëve dhe firmave. Ndërkohë që roli tradicional i mbikëqyrësve ka të bëjë me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave prej bankave, të cilët synojnë të përmirësojnë mbrojtjen e konsumatorëve dhe stabilitetin financiar, CP3 u cakton mbikëqyrësve role që i bëjnë ata të përfshirë thellë në vendimet e vogla të administrimit të rrezikut. Meqenëse bankat kanë përparësi në kompetencën teknike dhe njohuritë mbi teknikat e tyre specifike, mbikëqyrësit do të duhet ta fitojnë këtë njohuri ose nuk do të jenë në gjendje të mbikëqyrin si duhet. Bankave dhe mbikëqyrësve u është dashur të punojnë së bashku në Basel II dhe akoma më tepër bashkëpunim kërkohet, për të zgjidhur çështjet që janë lënë për t'u përcaktuar në nivel kombëtar.

Përfshirja e thellë e mbikëqyrësve si rregullatorë dhe administratorë të rrezikut, do të thotë se çdo falimentim banke mund të shikohet si dështim i mbikëqyrësit dhe në mënyrë indirekte si falimentim i qeverisë. Hezitimi për t'i lejuar bankat të falimentojnë mund të rritet edhe më tepër, e si pasojë motivimet për të marrë rreziqe nuk ulen gjë që është qëllim i Basel II. Rreziku për krizë të përgjithshme mund të rritet në vend që të ulet. Rrethi i mbyllur i motivimit për të marrë përsipër rreziqe, një nevojë e shtuar për përfshirje të mbikëqyrësve dhe shtimi i kapjes së rregullatorëve do të pengonin qëllimin e trajtimit të renditjeve të brendshme.

4.16.3. Shpërndarja e informacionit dhe disiplina e tregut

Rreziqet e kapjes rregullatore mund të ulen nga shtimi i disiplinës në treg. CP3 ul kërkesat për dhënie informacioni, sidomos në lidhje me renditjet e brendshme. Për më tepër, vendimet e detajuara për kërkesat për dhënie informacioni u lihen mbikëqyrësve kombëtarë, të cilët mund të konkurrojnë në neglizhencë. Ne vazhdojmë të rekomandojmë emetimin e detyruar të borxhit të subordinuar për të përmirësuar disiplinën në treg.

4.16.4. Kërkesat për kapital për rrezik operacional

Rreziku operacional është i ndryshëm nga rreziku i kreditit dhe i tregut. Ai ka të bëjë me shkaqet dhe jo me pasojat e humbjeve. Ulja e rrezikut operacional ka të bëjë me administrimin e mirë. Ilaçi kryesor për humbjet operacionale nuk është kapitali i vet por qeverisja e mirë e korporatës, planifikimi i hershëm dhe sigurimi.

CP3 specifikon tre trajtime për llogaritjen e kërkesave të kapitalit për rrezikun operacional. Dy prej tyre (“trajtimi i treguesit bazë” dhe “trajtimi i standardizuar”) bazohen në të ardhurat bruto të bankës në tërësi ose në fusha të caktuara. Trajtimi i tretë – “trajtimi i matjes së avancuar” – tregon se Komiteti i ka parasysh bazat e dobëta konceptuale të një ngarkese të rrezikut operacional, kur sugjeron që bankave t'u jepet një nivel fleksibiliteti pa precedent për të zhvilluar trajtime për të matur rrezikun.

Konteksti i duhur për të trajtuar rrezikun operacional është shtylla e dytë (kontrolli mbikëqyrës) por KEHRRF pranon si një rregullim pragmatik një pagesë fikse (në varësi të trajtimit të treguesit bazë) për të kompensuar për uljen e kapitalit në sistemin bankar për shkak të regjimit të ri të rrezikut të kreditit.

4.16.5. Studimi mbi impaktin sasior 3

Më 5 maj të 2003, Komiteti i Bazelit publikoi një paraqitje të rezultateve globale në lidhje me studimin mbi impaktin sasior (SIS3). Objektivi i studimit ka të bëjë me matjen e impaktit të propozimeve të fundit të Bazelit II, mbi kërkesat për kapital minimal. Për trajtimin e standardizuar SIS3, raporton një rritje të përgjithshme të moderuar (rrezik krediti dhe rrezik operacional) në kërkesat për kapitalin rregullator. Bankat e mëdha ballafaqohen me një rritje mesatare prej 11 dhe 6 për qind në G10 dhe BE respektivisht, ndërsa bankat e vogla përballen me një rritje prej 3 dhe 1 për qind respektivisht. Rezultatet janë mjaft të ndryshme për trajtimet e renditjeve të brendshme. Në trajtimin bazë të renditjeve të brendshme kërkesa mesatare për kapital për bankat e vogla bie me 19 dhe 20 për qind në G10 dhe BE respektivisht, ndërkohë që mbetet gati njëloj për bankat e mëdha (rritje prej 3 për qind në G10 dhe 4 për qind ulje në BE).

KEHRRF mendon se këto vlerësime janë tepër konservatore dhe se do të ketë ulje të konsiderueshme të kërkesës për kapital rregullator. Ne e bazojmë këtë vlerësim në faktin se vetë Komiteti i Bazelit thotë që beson se rezultatet, sidomos nga aktivitet jo-me pakicë, tentojnë të mbivlerësojnë kërkesat minimale për kapital *gjatë zbatimit*. Kjo qëndron sidomos në fushat e uljes së rrezikut të kreditit, ku ka qenë e vështirë për bankat e shumë vendeve të njohin të gjitha llojet kolateralit, të cilat lejojnë uljen e kërkesave për kapital.

SIS3 do të thotë se kërkesa rregullatore për kapital gjatë zbatimit të saj do të jetë mjaft më e vogël se parashikimet aktuale. Ulja e madhe në sasinë e kapitalit të mbajtur nga bankat në BE dhe G10 është kundër objektivit të Komitetit të Bazelit, dhe mund të ketë pasoja të këqija për stabilitetin e sistemit bankar.

4.16.6. Si duhet të reagojë BE ndaj trajtimit të SHBA?

Me adoptimin e Basel II, autoritetet amerikane kanë propozuar që ai duhet aplikuar në mënyrë të detyruar ndaj rreth 10 bankave aktive në tregjet ndërkombëtare. Autoritetet presin që 10 banka të tjera ta adoptojnë në mënyrë vullnetare. Bankat e tjera mund të zbatojnë një version kombëtar të Akordit të Bazelit të vitit 1988. Logjika pas këtij vendimi ka të bëjë me kompleksitetin e kuadrit për të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë rregullatorët dhe administratorët e lartë të bankave. Ne i njohim bazat e trajtimit amerikan dhe jemi dakord me shqetësimin në lidhje me kompleksitetin, por gjithashtu jemi të shqetësuar në lidhje me efektet e trajtimit amerikan ndaj kushteve të barabarta të lojës dhe ndikimet për sistemet bankare jashtë G10.

Në nivelin e BE, KEHRRF rekomandon adoptimin e CADIII, i cili do ta bënte Basel II të detyruar vetëm për bankat dhe firmat e mëdha dhe aktive në tregjet ndërkombëtare. Institucione më të vogla duhet të kenë opsionin e adoptimit të një versioni të thjeshtuar të “trajtimit të standardizuar” ose rregullat e rinj, në qoftë se ato mendojnë se është në interesin e tyre.

4.16.7. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME)

KEHRRF shpreh keqardhje se çështja e kërkesave për kapital për SME është bërë një çështje politike, ndërkohë që duhet të jetë çështje ekonomike. Në qoftë se ka shtrembërime në tregjet e kredive për SME ato duhet të rregullohen nëpërmjet reformave thelbësore të shoqëruara nga masa tranzicioni dhe jo nga trajtime *ad hoc* në favor të SME, si kërkesat e diferencuara për kapital të bazuara në madhësinë e kredimarrësit apo të riklasifikimit të kredive të vogla si blerje të vogla.

4.16.8. Ciklet

Zbatimi i Basel II mund të rrisë efektet e cikleve ndaj kërkesave për kapital, sepse bankat do të duhet të shtojnë bazën e kapitalit të tyre gjatë periudhave të rënies ekonomike kur kredimarrësit duken më të rrezikshëm. Megjithëse disa efekte të cikleve janë të pamënjanueshme, masat rregullatore nuk duhet ta përkeqësojnë gjendjen. Çështja ka nevojë për vëmendje të veçantë dhe kërkon analizë të mëtejshme. Një mënyrë për të rregulluar është nëpërmjet rezervave, ku rezervat grumbullohen në kohë të mira në mënyrë që të përmirësohen burimet për t'u mbrojtur nga falimentimet në kohë të vështira. Kjo perspektivë mund të jetë një trajtim plotësues ndaj Basel II dhe do të ndihmojë në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe financiar.

4.17. Transferimi i rrezikut të kreditit nga bankat në institucione financiare jobanka (35)

Gjatë këtyre pesë viteve bankat kanë kaluar një sasi të madhe të rrezikut të kreditit tek institucionet financiare jobanka dhe te bankat e tjera. Në Evropë dhe SHBA bankat kanë qenë blerëse neto të mbrojtjes nga rreziku i kreditit, duke shitur kredi në mënyrë direkte ose indirekte nëpërmjet zëvendësimit të saj me aksione ose nëpërmjet blerjes së derivativëve të kreditit. Vlera e tregut për derivativa të kreditit në vetvete është parashikuar të kalojë dyfishin nga 2 trilion USD në vitin 2002 në 5 trilion usd në vitin 2004, ndoshta duke kaluar 10 për qind të stokut të kredive. Sipas Fitch (shtator 2003) industria e sigurimeve ka thithur 381 miliard usd rrezik krediti nëpërmjet derivativeve. Nga kjo sasi 229 miliardë kanë si origjinë industrinë bankare.

Fenomeni i tregtimit të rrezikut dhe kalimi i tij nga një lloj institucioni tek një tjetër nuk siguron rritjen e stabilitetit financiar. Megjithatë, mund të rrisë aftësinë e sistemit financiar në tërësi për të thithur rrezik dhe mund të përmirësojë eficiencën e shpërndarjes së rrezikut. Tregtia në rrezik krediti gjithashtu, u mundëson bankave të rregullojnë profilin e rrezikut të portofoleve të tyre. Sidoqoftë, rritja e shpejtë në tregtimin dhe kalimin e rrezikut është bërë një shqetësim për rregullatorët dhe praktikuesit.

S4.17.1. Tregtia e rrezikut dhe efienca

Megjithë ekspertizën e tyre në vlerësimin e rrezikut të kreditit, bankat mund të jenë më pak të përshtatshme se institucione të tjera financiare, për të mbajtur sasi të mëdha të rrezikut të kreditit. Prandaj, mund të jetë e përshtatshme për ato që ta shesin rrezikun e kreditit tek ato që kanë më shumë mundësi për të mbajtur një rrezik të tillë. Ky rast qëndron kur tregjet financiare funksionojnë mirë, në kuptimin që arsyet e shitësve dhe të blerësve nuk janë shtrembëruar dhe ka informacion për të gjithë aktorët në treg. Edhe në qoftë se nuk ka shtrembërime, tregtia e rrezikut është efiçente kur rregullat korrigjojnë këto shtrembërime nëpërmjet metodave të ndryshme, për shembull kërkesave për kapital. Një pjesë e transferimit të rrezikut të kreditit duket sikur shtyhet nga mundësitë e arbitrazhit, që lindin nga kërkesa të ndryshme për mjaftueshmërinë e kapitalit që aplikohen ndaj llojeve të ndryshme të firmave financiare. Për shembull, një kompani sigurimi blen një kredi nga një bankë, sepse përballet me kërkesa më të ulëta për kapital mbi atë kredi. Përparësia financiare e arritjes së një raporti më të mirë të kthimit ndaj kapitalit të kërkuar mund të ndahet ndërmjet bankës dhe kompanisë së sigurimeve. Nën çfarë kushtesh transferimi i rrezikut rrit mundësinë për mungesë të përgjithshme stabiliteti dhe ul eficiencën e shpërndarjes së rrezikut? Ne identifikojmë burimet e

mëposhtme të tejkalimit të rrezikut të marrë përsipër në sistemin financiar, për shkak të transferimit të rrezikut në institucione financiare jobanka dhe sidomos në kompani të sigurimit të jetës:

1. Bankat mund të jenë në gjendje të anashkalojnë peshën e kërkesës për kapital duke shitur rrezik.
2. Rreziku mund të transferohet në institucione me ekspertizë të vogël në vlerësimin e rrezikut ose që nuk kanë motivim për ta monitoruar.
3. Do të kishte konflikte interesi ndërmjet njësive të ndryshme brenda konglomeratëve financiarë në lidhje me njësinë e cila duhet të mbajë rrezikun.

4.17.2. Bankat mund të jenë në gjendje të çlirohen nga kërkesat për kapital duke shitur rrezik

Bankat kanë motivim të sigurojnë kreditë, në qoftë se mund të ulin kërkesat për kapital dhe t'ua shesin letrat me vlerë firmave, të cilat nuk kanë pengesa të tilla. Kështu, ato mund të japin kredi të tjera dhe të zhvillojnë marrëdhëniet me klientët. Kontratat në lidhje me sigurimin e kredive janë shpesh mjaft komplekse, sidoqoftë, pasoja qëndron në paqartësinë se çfarë pjese e rrezikut mbetet me bankën. Për më tepër, pjesa kryesore e kuadrit ligjor që lejon sigurimin është e pa testuar. Kështu, banka mund të përballet me rreziqe ligjore në kohë të vështira.

Një bankë që shet rrezik gjithashtu, mund të dëmtojë reputacionin e saj si vlerësuese dhe monitoruese kredish. Prandaj, mund t'i duket e arsyeshme që të mbajë një pjesë të humbjeve të lidhura me rrezikun e shitur, në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e saj. Për këtë arsye, duhet të ketë kapital në mënyrë që të ruhet ndaj rrezikut mbi reputacionin si dhe rreziqet ligjore, megjithëse këto rreziqe nuk preken nga rregullat e Bazelit për mjaftueshmërinë e kapitalit.

4.17.3. Rreziku mund të transferohet në institucione me ekspertizë më të ulët për vlerësimin e tij ose në institucione me motivimin më të vogël për ta monitoruar

Zakonisht, rreziku i kreditit transferohet nga bankat në kompani sigurimesh, fonde pensionesh, banka të tjera dhe në disa raste në korporata jofinanciare. Çështja ka të bëjë me atë se jobankat, të cilat blejnë rrezik janë të ndërgjegjshme për rrezikun që po marrin. Kompanitë e sigurimeve kanë më pak ekspertizë sesa bankat në këtë fushë. Të paktën, kompanitë e sigurimeve ballafaqohen me një fazë edukimi, gjatë të cilës duhet të profesionalizojnë mundësitë e tyre të vlerësimit të rrezikut. Problemi i vlerësimit të duhur të rrezikut shtohet nga natyra jotransparente e tregjeve për kredi bankare dhe derivativave të kredive (mungesë të dhënash, metodologji të ndryshme kontabël etj.). Disa kompani sigurimesh kanë zbuluar nënvlerësimin e rrezikut të kreditit të transferuar dhe kanë vendosur të ulin aktivitetet e tyre në këto tregje.

Mbikëqyrësi mund të dojë të sigurohet që ata që blejnë ose thithin rrezik nuk nënvlerësojnë rreziqet dhe thithin më tepër rrezik sesa mund të mbajnë, duke pasur parasysh ndryshimet në kapital. Nevoja për ndërhyrje aktive është mjaft e mundshme, në qoftë se informacioni i duhur aksionerëve dhe blerësve potencialë të policave të sigurimit nuk u jepet dhe në qoftë se ndryshimi nga një kompani sigurimi në një tjetër është i vështirë, për ato të cilat mbajnë polica të tilla.

Historia dhe teoria mësojnë se duhet treguar maturi për shkak të rritjes së shpejtë të tregjeve për instrumenta të reja financiare, si transferimi i rrezikut përpara se pjesëmarrësit në treg të ballafaqohen me një nivel të tërë kushtesh ekonomike. Megjithëse ka pasur falimentime të mëdha gjatë periudhave të këqija ekonomike si ato të Enron dhe Worldcom, këto nuk kanë qenë të shkallës së vëzhguar gjatë viteve 1990-1992, kur pati ulje në tregjet e pronës tregtare pas një bume në kreditim. Rritja e tregjeve për instrumente të transferimit të rrezikut ka qenë eksplozive që nga periudhat e rënies ekonomike dhe akoma nuk është vëzhguar ndonjë periudhë stresi ekstrem. Prandaj, është e vështirë për të bërë vlerësime të mundësive mbi humbjet e mundshme. Nën kushte të tilla, ka rrezik që vendosja e çmimit për rrezikun mund të jetë e pasaktë dhe kapitalizimi i pamjaftueshëm.

Përkeqësimi i situatës në terma afatshkurtër është fakti se informacioni mbi ekspozimet e instrumenteve CRT është i pamjaftueshëm, në terma të vëllimit të ekspozimit nga çdo institucion dhe termat e ndryshëm nën të cilët transferohet ekspozimi. Mosdhënia e informacionit nga institucione individuale reflektohet në pamundësinë e autoriteteve për të diktuar këto transferime të rrezikut të kreditit.

Rregullatorët mund të ndihmojnë në përmirësimin e disiplinës së tregut duke përmirësuar transparencën. Kjo mund të arrihet duke u kërkuar siguruesve dhe institucioneve të tjera që marrin rrezik, të japin informacion të plotë dhe në kohë mbi situatën e tyre financiare sipas parimeve të sugjeruara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) – diçka e cila akoma nuk është praktikë e zakonshme në të gjithë vendet evropiane, siç tregohet nga zhvillimet e fundit në Gjermani.

4.17.4. Ka konflikt interesi ndërmjet njësive të ndryshme brenda një konglomerati financiar

Tregjet për shërbime financiare dominohen nga njësi që u përkasin konglomeratëve financiarë, ku një bankë dhe një kompani sigurimesh mund të bashkëekzistojnë. Në qoftë se tregjet për një nga shërbimet financiare të ofruara nga konglomerati nuk janë konkurrese, njësia e cila operon nën konkurrencë joperfekte mund të vendosë çmime për t'i shërbyer qëllimit të një grupi të caktuar aksionerësh në kurriz të të tjerëve. Në qoftë se kjo ndodh, qeverisja e grupit dhe e njësive të tij përbën një problem. Për shembull, në një konglomerat i cili përbëhet nga një bankë dhe një kompani sigurimi të jetës, mbajtësit e policave të sigurimit të jetës kanë interes në mbajtjen e fitimeve afatshkurtra brenda kompanisë së sigurimit të jetës, në mënyrë që të ulin rënien e mundshme të vlerës së aseteve. Në të njëjtën kohë, aksionerët mund të kenë interes në shpërndarjen e fitimeve. Ky konflikt interesi theksohet në qoftë se kompania e sigurimit të jetës qeveriset si një kompani e përbashkët, në të cilën shpërndarja e fitimit është e kufizuar, ndërkohë që konglomerati si i tërë është i inkorporuar. Në shumë vende evropiane kompanitë e sigurimit të jetës qeverisen si të përbashkëta, ndërkohë që janë pjesë e një grupi të inkorporuar. Brenda grupeve të tilla mund të jetë në përparësinë e aksionerëve për të mbiçmuar transfertat e rrezikut të kreditit tek kompania e sigurimeve, në mënyrë që të lëvizë fitimet nga ajo në kompani që nuk ka kufizime shpërndarjeje. Rregulla kundër transferimeve të brendshme të fitimit mund të krijohen duke detyruar ndarjen e strukturave qeverisëse të njësive të ndryshme.

4.17.5. Rekomandime

Rregullimi i integruar mund të jetë përgjigja e duhur ndaj rritjes së ekspozimit të rrezikut të përbashkët të sektorëve bankarë dhe jobankarë, i gjeneruar nga transfertat e rrezikut të kreditit. Qëllimi duhet të jetë që “praktikat më të mira” në administrimin e rrezikut të përdoren nga të gjitha institucionet financiare.

Ka nevojë për shpejtësi në krijimin e rregullave që kanë të bëjnë me rrezikun, të cilët inkurajojnë disiplinën në treg në sektorët financiarë. Disiplina e tregut duhet të plotësohet nga procedura makro të mbikëqyrjes, të cilat vlerësojnë rrezikun agregat të kreditit duke testuar rrezikun e kreditit ndaj streseve në sektorin financiar dhe ekonominë, në përgjithësi.

Duhet theksuar nevoja për transparencë. Siguruesve dhe të tjerëve që blejnë rrezik, duhet t'u kërkohet që të japin informacion të plotë dhe në kohë, sipas parimeve të sugjeruara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Kjo do të lehtësojë shkëmbimin e të dhënave dhe të *benchmarkut* nëpër Evropë.

Ne kontestojmë nëse është e përshtatshme që brenda një konglomerati të inkuorporuar financiar, një ose më shumë nga njësitë e tij qeverisen si kompani të përbashkëta ndërkohë që interesat e aksionerëve kryesorë ndryshojnë nga interesat e aksionerëve të grupit. Në rastet kur funksionon në këtë mënyrë, duhet siguruar të paktën qeverisja e pavarur e njërive.

4.18. Sfida për rregullatorët financiarë në vendet e sapopranuara në BE (36)

1 maji 2004 shënoi datën e hyrjes në BE të 10 anëtarëve të rinj, nga të cilët 8 janë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL). Që nga viti 1989, këto vende kanë bërë progres të madh në tranzicionin drejt ekonomive të tregut dhe zhvillimit të sektorëve financiarë. Për më tepër, ato gati e kanë përfunduar zbatimin e të gjitha ligjeve dhe rregullave të BE-së në kuadret e tyre ligjore.

Sektorët bankarë në vendet e EQL janë kryesisht në duar të privatëve. Bankat gjithashtu, duket sikur janë me fitim, raportet e kapitalit janë të shëndetshme në shumicën e tyre. Një rezultat mbresëlënës i procesit të tranzicionit është se sistemet bankare tashmë dominohen nga banka, të cilat kontrollohen nga banka të huaja. Përqindja e aseteve të këtyre bankave kalon 70 për qind në shumicën e këtyre anëtarëve të rinj, me një përjashtim, atë të Sllovenisë, ku përqindja e mjeteve, e zotëruar nga të huajt është më pak se 20 për qind. Kontrolli i huaj i bankave të EQL, të cilat normalisht funksionojnë si degë, si dhe përqendrimi i lartë i tregut ndërmjet tyre, krijojnë sfida për rregullatorët në lidhje me mbikëqyrjen e bankave të huaja dhe zhvillimet e tregjeve të letrave me vlerë.

4.18.1. Nevoja për kordinim të mbikëqyrjes bankare në vendin ku është regjistruar banka dhe në vendin ku ka degë

Sipas standartit në praktikat mbikëqyrëse ndërkombëtare, përgjegjësia për mbikëqyrjen e një dege bie mbi rregullatorët e të dyja vendeve. Përgjegjësia e dyfishtë është asimetrike, për shkak se mbikëqyrësi i vendit ku është regjistruar banka ka përgjegjësi për të parë degën në kontekstin e tërë institucionit, ndërkohë që mbikëqyrësi në vendin ku banka ka degë fokusohet vetëm tek dega. Megjithëse ka kontakte të shpeshta ndërmjet mbikëqyrësve, shkalla deri në të cilën mbikëqyrësi i vendit ku banka është e regjistruar duhet të ndajë informacion në lidhje me bankën, është e paqartë.

Në një dokument të Komitetit të Bazelit të tetorit 1996 mbi “mbikëqyrjen e bankingut ndërshtetëror”, paragrafi 30, ka një referencë mbi rrjedhjen e informacionit ndërmjet

mbikëqyrësve. Ky paragraf thotë se mbajtja e mbikëqyrësve të vendit ku banka ka degën në dijeni të “ndryshimeve të rëndësishme negative në situatën e përgjithshme të grupit bankar që vepron në juridiksionin e tyre [...] do të jetë një çështje mjaft e ndjeshme për mbikëqyrësit e vendit ku banka është regjistruar (në lidhje me substancën dhe kohën kur jepet informacioni) dhe se vendimet mbi dhënien e informacionit është e nevojshme të bëhen rast pas rasti”. Direktiva e Konsoliduar e BE-së për bankingun, e vitit 2000 (37) i referohet nenit 56 të masave për të lehtësuar mbikëqyrjen e konsoliduar. Autoritetet kompetente të çdo vendi anetar duhet t’i komunikojnë njëri-tjetrit “çdo informacion që mund të lejojë ose ndihmojë kryerjen e mbikëqyrjes mbi një bazë të konsoliduar”. Nga pikëpamja jonë, kjo nuk e forcon në mënyrë të prekshme nevojën për dhënie informacioni nga mbikëqyrësi i vendit ku banka është regjistruar te mbikëqyrësi në vendin ku ajo ka degën.

Potenciali për mungesa në dhënien e informacionit krijon mundësi dhe motivim për rritjen e rrezikut të degëve të bankës. Në mënyrë specifike, në qoftë se një bankë shumëkombëshe në tërësi përballet me probleme, ajo mund ta kalojë rrezikun në një degë ku pret që të ketë mundësinë më të madhe për mbështetje nga qeveria. Në qoftë se dega falimenton sistemi i sigurimit të depozitave të vendit ku ndodhet dega është përgjegjës për të dhënë mbështetje. Kjo do të thotë humbje, të cilat mbulohen nga taksapaguesit vendas. Përqendrimi i lartë i bankave në një vend pritës, shton mundësinë e problemeve pasi një qeveri mund të mos ketë vullnetin të pranojë falimentimin e një dege, e cila përfaqëson një pjesë të madhe të sistemit financiar të vendit. Në këto kushte, dega e bankës me shumë mundësi do të marrë më tepër rrezik. Një sjellje e tillë do të bëhet edhe më serioze për vendin pritës, në qoftë se mbikëqyrësi mund të mënjanojë përgjegjësi për problemet e bankës duke neglizhuar mundësinë e moskryerjes së pagesave nga banka, të cilat mund të çojnë në transferimin e rrezikut te dega e bankës.

KEHRRF vë re se disa nga vendet e reja anëtare kanë kërkesa mjaft strikte dhe ne mendojmë se kjo vjen si rezultat i shqetësimeve për mungesën e informacionit të dhënë nga mbikëqyrësit e vendit ku është regjistruar banka, në lidhje me institucionin mëmë. Për sa kohë që këto kërkesa shkojnë përtej nevojave për informacion, të cilat do të siguronin stabilitet, ato përbëjnë një kosto për shkak të inefficiencës për ekonominë e vendit ku banka ka degë.

Në mënyrë që të krijohet një kundërbalancë ndaj problemeve të mësipërme, KEHRRF rekomandon që dhënia e informacionit duhet të zgjerohet mjaft në lidhje me shëndetin e institucionit në tërësi. Shtimi i rrjedhjes së informacionit do të ishte mjaft i vlefshëm për vendet e reja anëtare, duke pasur parasysh aktivitetin e lartë të bankave të huaja. Përveç përfitimeve në stabilitet financiar, do të ulte nevojën për kërkesa strikte dhe kostot e tyre të identifikuar më lart.

Një kërkesë për dhënie informacioni gjithashtu, do të ishte e vlefshme për shkak të zbatimit të Basel II, ku sistemet e brendshme të renditjes të degëve duhet të vlerësohen nga të dy mbikëqyrësit. Do të ishte mjaft e vlefshme sidomos për mbikëqyrësit e vendit që ka degë banke, në vendet e reja anëtare, të cilat kanë degë të rëndësishme të bankave të huaja që po përballen me probleme, në lidhje me vlerësimet, për shkak të mungesës së burimeve dhe të dhënave statistikore.

4.18.2. Roli i tregjeve të letrave me vlerë

Roli mbizotërues i bankave të huaja në vendet e reja anëtare, shoqëron strukturat e tyre financiare ku mundësitë për financim janë të kufizuara. Firmat mund të mbeten të kufizuara në zgjedhjet e tyre për financime dhe familjet të kenë një numër të kufizuar mundësish investimi. Tregjet e letrave me vlerë mund të japin një burim alternativ të financimit të jashtëm për firmat si dhe për familjet, por këto tregje vazhdojnë të jenë të parëndësishme në vendet e EQL, megjithë inkurajimin nga qeveritë. Ato nuk kanë qenë në gjendje të ofrojnë sa duhet likuiditet me përjashtim të një numri të vogël aksionesh. Deri diku, është e natyrshme për tregjet e letrave me vlerë që të zhvillohen në mënyrë graduale gjatë procesit të zhvillimit financiar. Megjithatë, për hir të rritjes së qëndrueshme ekonomike është e dëshirueshme që të krijohen kushtet që tregjet e letrave me vlerë të zgjerohen. Kjo nuk do të thotë që ne jemi në favor të një subvencionimi të tregjeve të aksioneve në çdo vend. Nga pikëpamja jonë, as nuk është e nevojshme që çdo vend të ketë tregun e tij të aksioneve, sidomos duke pasur parasysh hyrjen në të ardhmen në Zonën Euro. Por, tregjet e letrave me vlerë duhet të lejohen të zhvillohen lirisht dhe të konkurojnë për firma dhe investitorë. E rëndësishme është që:

1. Firmat të jenë në gjendje të gjejnë burimet më të lira të financimit nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë, aty ku ato e shikojnë se është në avantazhin e tyre. Këto konsiderata duhet të përcaktojnë se ku të listohen.
2. Investitorët vendas duhet të jenë në gjendje të tregtojnë në mënyrë sa më të sigurtë dhe të menjëhershme në tregjet e huaja dhe vendase të letrave me vlerë.

Megjithëse shumë firma nuk janë aktualisht në një pozicion kur emetimi i borxhit është tërheqës, lindja e tregjeve të likuiditetit do të inkurajonte përdorimin e financimit privat të borxhit. Kjo është e rëndësishme për financimin në fazat fillestare sepse kapitalistët zakonisht kanë një rrugëdalje të vendosjes në tregjet e ekuitetit si objektiv përfundimtar. Financimi i kapitalit të firmave të reja është shpesh superior ndaj financimit bankar për projekte të reja, sepse bankat nuk dëshirojnë të marrin përsipër rreziqet e këtyre projekteve ku kolaterali është i kufizuar. Për më tepër, firmat që ofrojnë kapital për projekte të reja japin këshilla dhe ndihmë konkrete në fazat kritike të rritjes. Një përfitim tjetër nga tregjet e letrave me vlerë është se ato japin mundësi firmave të stabilizuara në treg për të emetuar letra me vlerë borxhi të listuara ose jo. Bonot afatmesme, letra tregtare dhe forma të tjera të financës të strukturuar mund të zëvendësojnë kreditë bankare dhe të përmirësojnë aksesin e firmave për fonde.

BE jep një kuadër rregullator për tregjet e letrave me vlerë nëpërmjet disa direktivave të cilat zbatohen nga vendet e reja anëtare. Ky proces legjislativ ka qëllimin që t'u lejojë tregjeve vendase të zhvillohen dhe të mundësojnë transaksionet ndërmjet shteteve nga investitorët dhe bursat. Vendet e reja anëtare duhet të përfitojnë nga mundësitë që jep ky proces.

Në mënyrë që tregjet e letrave me vlerë të funksionojnë si duhet likuiditeti është thelbësor. Ai kërkon një numër të mjaftueshëm pjesëmarrësish me informacion të besueshëm. Në këtë kontekst, ne vëmë re se fondet e pensionit po zhvillohen shpejt në shumë vende të EQL, pas reformave të këtyre sistemeve. Rritja e fondeve të pensionit do të nxisë zhvillimin e tregjeve të letrave me vlerë në EQL dhe hyrja në BE duhet të lehtësojë këtë për fondet e pensionit, për shkak të Direktivës së 2003 për Provizionet e Daljes në Pension nga Puna. Neni 18 mandaton qeveritë që t'u kërkojnë insitucioneve të

tilla të investojnë në përputhje me “rregullin e personit të kujdesëm”, dhe të mos i pengojnë fondet e pensionit të investojmë mbi 70 për qind të mjeteve të tyre në ekuitete ose në bono të korporatave (ose 100 për qind aty ku anëtarët e mbajnë rrezikun). Ato gjithashtu, duhet të lejojnë ndryshimet në valutë për deri në 30 për qind të portofolit. Kjo do të krijojë lehtësi për tregun duke ulur kufizimet e portofolit, të vendosura në disa vende të EQL dhe duke lejuar investime më të gjera. Ne rekomandojmë që vendet e EQL nuk duhet të përfitojnë pa justifikim ndaj klauzolës 6 të nenit 18, që u lejon rregulla më të ngurtë për investime në bazë individuale “në qoftë se ato janë të justifikuara me kujdes”.

4.19. Trajta të përbashkëta të të gjitha deklaratave

Deri tani, nuk ka pasur një sekuencë logjike të ose lidhje ndërmjet *çështjeve* të ndryshme që janë zgjedhur për diskutim në deklaratat e KEHRRF. Ka kaq shumë probleme në fushën e rregullimit financiar, të cilat duhet të trajtohen nga perspektiva evropiane, që nuk duket sikur ka nevojë që KEHRRF t'i zgjedhë temat në bazë të një strategjie të veçantë. Sidoqoftë, sipas *trajtim*it themelor ato merren me çështje rregullatore dhe mbikëqyrëse, deklaratat e ndryshme kanë mjaft gjëra të përbashkëta dhe kjo nuk është rastësi. Në të gjitha deklaratat, probleme të rregullimit dhe të mbikëqyrjes financiare shikohen dhe diskutohen si probleme me incentiva; dhe në çdo rast rekomandimet kanë për qëllim të nxjerrin më në pah një problem incentivash dhe për të dhënë zgjidhje të përshtatshme për këto incentiva mbi problemet.

Ka gjithmonë çështje incentivash në dy nivele: në nivelin e njësive ekonomike të cilat janë subjekt i një skeme rregullatore ose standardesh, do të ketë incentiv për njësi të tilla që të veprojnë në mënyra që janë kundër interesave të agjencive rregullatore ose mbikëqyrëse ose të paktën në të kundërt me objektivat e tyre të deklaruar. Për shembull, banka individuale mund të jenë në pozion që të emetojnë shumë kredi me rreziqe të lidhur. Në të njëjtën kohë, ka një incentivë për agjencinë rregullatore ose për njerëz që punojnë në këto agjenci, për të vepruar në një mënyrë, e cila është kundër interesave të agjencisë si institucion dhe qëllimeve të deklaruar të institucionit, në një situatë të caktuar. Neglizhenca rregullatore, mendimi se disa banka “janë tepër të mëdha për të falimentuar” dhe lloje të ndryshme ndërhyrjesh në banka me probleme, janë manifestim i këtij problemi të mospërputhjeve të incentivave dhe mungesës së konsistencës.

Problemet e incentivave në të dyja nivelet përkeqësohen ose shkaktohen në fillimet e tyre nga probleme informacioni. Kjo hedh dritë mbi një shtresë tjetër të problemeve me incentivat. Në shumë kontekste, incentivat për të prodhuar, zbuluar, mbledhur dhe shpërndarë informacionin e kërkuar nuk janë të strukturuar në një mënyrë optimale. Problemet me incentivat dhe informacionin janë të lidhura dhe ato tentojnë të përkeqësojnë njëri-tjetrin. Rekomandimet e KEHRRF bazohen në premisën se, në qoftë se mbikëqyrja duhet të jetë efektive ajo duhet të trajtojë rrjetin e incentivave të ndërvarura dhe problemet e informacionit në të dyja nivelet dhe gjithashtu duhet t'i rregullojnë këto probleme në nivelet ku ato hasen. (38) deklaratat e KEHRRF tentojnë të konfirmojnë një trajtim të tillë, i cili gjithashtu është në përputhje me teorinë e formave optimale të sistemeve financiare, është i nevojshëm dhe mund të zbatohet në praktikë.

4. Vlerësimi dhe parashikimi

Siç jemi munduar të argumentojmë, detyra e mbikëqyrjes financiare ka të bëjë me zgjidhjen e problemeve të incentivave dhe në mënyrë më specifike me krijimin e incentivave të duhura për institucionet e rregulluara dhe për rregullatorët që të prodhojnë, të komunikojnë dhe të përdorin informacionin e duhur në mënyrë të duhur. Çdo lloj rregullimi në nivel evropian, duhet të përballet me problemin shtesë që vende të ndryshme evropiane dhe sidomos sistemet e tyre financiare, ndryshojnë mjaft dhe në pikëpamje të rëndësishme. (39) Këto diferenca nuk mund të injorohen, përse kohë që Komuniteti Evropian i ka njohur që në fillimet e viteve '80. Prandaj, prodhimi, komunikimi dhe përdorimi i informacionit të duhur në mënyrën e duhur mund të nënkuptojë gjëra të ndryshme në vende të ndryshme dhe në qoftë se mbikëqyrja financiare në nivel evropian duhet të jetë kompatibël me sistemet ligjore, kulturore, ekonomike dhe sociale të vendeve individuale ku aplikohet. Por në praktikë, kjo do të thotë që ka çështje të rregullimit financiar për të cilat nuk mund të krijohet një politikë e përgjithshme evropiane, 40 ose për të cilën një politikë që mund të konsiderohet optimale nuk mund të zbatohet në mënyrë të suksesshme. Por, fakti që jo gjithmonë do të ketë një zgjidhje perfekte, e cila mund të zbatohet në nivel evropian nuk duhet përdorur si pretekst për të ndaluar së kërkuari për strategji optimale rregullatore për Evropën në tërësi. Me të vërtetë, ndërkohë që është e rëndësishme të kemi parasysh pengesat që dalin gjatë gjetjes së një zgjidhjeje të përbashkët për probleme konkrete, është po aq e rëndësishme të njohim përfitimet e mundshme të një trajtimi ndërkombëtar. Duke pasur parasysh konsiderimet e të dyja aspekteve kjo përbën një kontribut në zhvillimin e një “kulture rregullatore” evropiane.

Në punën e tij KEHRRF ballafaqohet me probleme të cilat janë analoge me ato që mundohet të trajtojë në deklaratat e tij. Në të vërtetë, në aktivitetet e KEHRRF problemet me incentivat dhe informacionin dhe çështje të heterogjenitetit, ndërthuren në një mënyrë komplekse dhe ato i bëjnë disa gjëra dhe të tjera gati të pamundura. Megjithatë, përpjekja për të tejkaluar këto probleme ia vlen. Për shkak të nevojës, KEHRRF është një ndërmarrje e guximshme. Tek e fundit, ajo përfshin veprimet e një grupi, që nuk ka mandat formal nga ndonjë institucion, anëtarët e të cilit nuk janë të detyruar të marrin pjesë rregullisht në takime dhe takimet e të cilit në çdo rast janë të shkurtra dhe jo të shpeshta, por qëllimi i të cilit është që të prodhojë deklaratat kuptimplota dhe të nxjerrë rekomandime mbi çështje të rëndësishme dhe të vështira. Vetëm koha do të tregojë dhe të tjerët do ta gjykojnë, nëse kjo ndërmarrje është e duhur dhe e vlefshme dhe nëse KEHRRF mund të arrijë qëllimet që i ka vënë vetes.

Problemet me incentivat dhe informacionin me të cilat përballet KEHRRF në punën e tij, janë ndoshta pengesat më të mëdha për suksesin e aktivitetit të tij. Ka dy arsye për këtë. Së pari, është çështja nëse është e mundur të mobilizohet informacioni të cilin supozohet se e kanë anëtarët e komitetit, të komunikohet, të përpunohet dhe të transformohet brenda grupit dhe të shpërndahet përfundimi dhe çështja se nga vijnë incentivat për të dhënë informacion. Së dyti, ka një fakt të thjeshtë se deklaratat e KEHRRF vetëm mund të arrijnë të komuniteti rregullator, në qoftë se informacioni i deklaratave është interesant për gazetarë të motivuar, të cilët janë të nevojshëm si ndërmjetës dhe “shumëfishues” në procesin e shpërndarjes, të vijnë në konferencat e shtypit, të dëgjojnë çfarë thuhet në këto prezantime, t'i lexojnë vetë deklaratat dhe pastaj të shkruajnë mbi to. Por, sigurisht ata nuk mund të detyrohen ta luajnë këtë rol. Së fundi, deklaratat duhet të jenë të vlefshme për rregullatorët, në mënyrë që ata të lexojnë çfarë ka për të thënë KEHRRF dhe pastaj të

konsiderojnë rekomandimet e tij. Dhe kjo do të thotë që ata kanë nevojë për informacion dhe incentiva, të cilat duhet të përçohen nga deklaratat.

Kështu, problemet e informacionit dhe të incentivave janë relevante në disa nivele. Si dhe rregullimi financiar, “projekti KEHRRF” mund të shikohet si çështje e hartimit të mekanizmit. Sigurisht, prodhimi i deklaratave jointerese, të pavlera ose të gabuara do të ishte një arsye për palët e ndryshme, bashkëpunimi i të cilave kërkohet për të arritur objektivin e komitetit – anëtarët, “shumëfishuesit” dhe rregullatorët – të ndalojnë së luajturi rolet e tyre. Vetëm koha do ta tregojë nëse ata do të vazhdojnë të bashkëpunojnë në këtë ndërmarrje në terma afatgjatë. Por, bazuar në përvojën e KEHRRF deri tani, ne jemi optimistë që kështu do të ndodhë.

Heterogjeniteti është një potencial i rëndësishëm për pengesa për KEHRRF, duke pasur parasysh ndryshueshmërinë e interesave të anëtarëve dhe rrethanat akademike, dhe numrin e madh të vendeve nga vijnë ata. Deri në njëfarë niveli, sidoqoftë, heterogjeniteti është një trajtë pozitive: një anëtar nga Norvegjia do të kishte mundësi të mësonte nga përvojat e ndryshme dhe do t’u jepte përparësi çështjeve të ndryshme në krahasim me një anëtar për shembull, nga Portugalia. Kjo siguron që në takimet e komitetit paraqitet mjaft informacion për t’u shqyrtuar. Gjithashtu, fakti se të paktën deri në një nivel të caktuar, çdo anëtar duhet të presë që të jetë përgjegjës për deklaratat e KEHRRF është pozitive. Kjo forcon incentivat e anëtarëve për të dhënë informacin dhe për të qenë të përfshirë në diskutime të sinqerta dhe nganjëherë të nxehta mbi çështje të debatueshme dhe siguron që grupi nuk nxjerr deklarata të pamenduara ose adopton pozicione të pabaza.

Referenca

- Basel Committee on Banking Supervision, 1988. International convergence of capital measurement and capital standards, Basel.
- Basel Committee on Banking Supervision, 1996. Amendment to the capital accord to incorporate market risks, Basel.
- Basel Committee on Banking Supervision, 1999. A new capital adequacy framework. First consultative paper, Basel.
- Basel Committee on Banking Supervision, 2001. The New Basel Capital Accord. Second consultative paper, Basel.
- Basel Committee on Banking Supervision, 2003. The New Basel Capital Accord. Third consultative paper, Basel.
- Basel Committee on Banking Supervision, 2004. International Convergence of Capital Measurement and Capital Standards—A Revised framework, Basel.
- Benink, H.A., Schmidt, R.H., 2000. Towards a Regulatory Agenda for Banking in Europe. In: Kaufman, G.G. (Ed.), *Research in Financial Services—Bank Crises: Causes, Analysis and Prevention*, vol.12. Elsevier Science/JAI Press, Amsterdam.
- Benink, H.A., Willborg, C., 2002. The New Basel Capital Accord: Making it Effective with Stronger Market Discipline. *Eur. Financial Manage.* 8, 103–115.
- Bhattacharya, S., Boot, A., Thakor, A., 1998. The economics of bank regulation. *J. Money Credit Banking* 30, 744–770.
- Boot, A., Thakor, A., 1993. Self-interested bank regulation. *Am. Econ. Rev.* 83, 206–212.
- Burghof, H.-P., Rudolph, B., 1996. *Bankenaufsicht: Theorie und Praxis der Regulierung*. Gabler Verlag, Wiesbaden.
- Caprio, G., 1997. Safe and sound banking in developing countries: we’re not in Kansas anymore. *The World Bank Working Paper*, Washington, DC.
- Demirgüç-Kunt, A., Detragiache, E., 1997. Banking crises around the world: are there any common threads? *IMF Working Paper*, Washington, DC.
- Demirgüç-Kunt, A., Huizinga, H., 1999. Market discipline and financial safety net design. *The World Bank Working Paper*, Washington, DC.
- Deutsche Bundesbank, 1998. Bankaufsichtrechtliche Risikosteuerungsmodelle und deren bankaufsichtliche Eignung, *Monatsbericht*, October 1998, pp. 69–84.
- Dewatripont, M., Tirole, J., 1994. *The Prudential Regulation of Banks*. MIT Press, Cambridge, MA.
- Dziobek, C., Frecuat, O., Nieto, M., 1995. Non-G-10 countries and the Basle capital rules: how tough a challenge is it to join the Basel club? *IMF Paper on Policy Analysis and Assessment*, No. 95/5, Washington, DC.
- Freixas, X., Rochet, J.-C., 1997. *Microeconomics of Banking*. MIT Press, Cambridge, MA.
- Hackethal, A., Schmidt, R.H., 2000. Finanzsysteme und Komplementarität, *Kredit und Kapital*, Beiheft No. 15: Neue finanzielle Arrangements: Märkte im Umbruch, pp. 53–102.
- Hellmann, Th., Murdoch, K., Stiglitz, J., 2000. Liberalization, moral hazard in banking and prudential regulation: are capital requirements enough? *Am. Econ. Rev.* 90, 147–165.
- Herring, R., Litan, R., 1995. *Financial Regulation in the Global Economy*. Brookings Institution, Washington, DC.
- Pagano, M., R’oell, A., 1992. Self-regulation of financial markets. In: Newman, P., Milgate, M., Eatwell, J. (Eds.), *The New Palgrave Dictionary of Money and Finance*, vol. 3. Macmillan Press, London.

Schmidt, R.H., Tyrell, M., 2004. What constitutes a financial system in general and the German financial system in particular. In: Krahen, J.P., Schmidt, R.H. (Eds.), *The German Financial System*. Oxford University Press, Oxford, pp. 19–67.

Schmidt, R.H., 2000. Banking regulation contra microfinance. *Savings Dev.* 24, 111–121.